

SPIRO FLOQI

## PERIUDHA ME FJALI TË VARUR KRYEFJALORE NË SHQIPEN E SOTME

### I. TIPARET SEMANTIKO-STRUKTURE TË FJALISË KRYESORE TE PERIUDHAT E TIPIT FTILLËZONJËS

Për fjalitë e varura kryefjalore, në gjuhën shqipe nuk është bërë deri tani ndonjë studim pak a shumë i hollësishëm. Vetëm në tekstet shkollore, të caktuara për shkallë të ndryshme të shkollave shqipe, përmbahen njohuri mbi këtë tip fjalie. Le t'i shqyrtojmë shkurtazi thëniet e këtyre teksteve.

Ilia Dilo Sheperi<sup>1</sup> e shtie këtë tip fjalie në një tip më të gjerë, të quajtur prej tij *fjalja e caktimit*. Fjalitë e caktimit «kufizojnë ose caktojnë kuptimin e gjerë të foljes kryesore dhe lidhen me anën e lidhëzave që dhe se» (fq. 191). Më tej, pasi përmend që «fjalitë e caktimit» përdoren si emëra, autori shton se «përdoren: si kryefjalë të fjalisë kryesore, si kallëzues, si kundrina të saj» (fq. 192). Fjalive kryefjalore, I.D. Sheperi u ka kushtuar vetëm dy radhë duke treguar vetëm se fjalitë e caktimit «përdoren a) si kryefjalë të fjalisë kryesore. P. sh. Duket se nuk do të vijë; më gjan që erdhi» (192). Siç shihet, Sindaksa e Sheperit është shumë e varfër në njoftime mbi këtë tip fjalie.

A. Xhuvani<sup>2</sup> ka pasuruar mjaft të dhënat mbi fjalinë kryefjalore, duke dhënë përkufizimin, duke treguar mjetet e lidhjes, duke bërë fjalë edhe për shënjat e pikësimit midis kryesores dhe fjalisë së varur (më sak, për mungesën e tyre). Te mjetet e lidhjes A. Xhuvani përmend: veç lidhëzave *se, qe*, edhe përemrat *lidhorë* (sic) *kush, ai që, ajo që, që. Ai që, ajo që*, ndonëse kuptimisht janë paralele me përemërin e pakufishëm *kush*, nuk përbëjnë akoma një «shprehje lidhore» të ngjizur: elementet përbërës ruajnë autonominë sintaksore dhe funksionale. Megjithatë sintaksa e A. Xhuvanit përben një hap përpara në krahasim me atë të parashkuesit të tij.

A. Justin Rrota<sup>3</sup> në tekstin e vet shkollor trajton shkurt por në mënyrë mjaft të plotë «fjalinë e kryefjalës». Edhe ai përmend veç lidhëzave *se, që*, «përemërat, ndajfoljet e fjalzat pyetëse; si dhe përemërat lidhës sikur: *kush, ai i cilli, shka, aj qi, kuj, kê, etj*». Duket që ai, si dhe A. Xhuvani, i merr si përemëra lidhore togjet *ai i cilli, aj qi*. Gjëja e re që sjell autori është se «këto lidhësa edhe mund të mungojnë e fjalit dahan prej piksimesh» (f. 71). Nga sa duket prej listës së shembujve, autori do ta ketë fjalën për shembullin 10 «Kemi për të pasun një vjet

1) Ilia Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskërishtes*. Vlorë, 1927.

2) A. Xhuvani, *Sintaksa shqip*, pjes'e dytë... Tiranë, 1934.

3) Justin Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Botim i dytë. Shkodër, 1943.

të mirë sivjet, më duket», ku fjalia *më duket*, e bashkuar asindetisht me pjesën tjetër përbën më fort një fjali ndërmjetëse se sa një fjali të varur kryefjalore, ndonëse gjenetikisht mund të shihet lidhja midis tyre. Përveç kësaj, ka edhe ndonji shembull që nuk paraqitet me fjali kryefjalore si p.sh.: Se po vjen kaq heret, kurrkund s'më vojt mendja», ku fjalia kryesore ka si kryefjalë emrin *mendja*, pavarësisht se kjo, me foljen *vojt* (s'më vojt), mund të përbëjë një shprehje foljore; fjalia e varur është kundinore sepse ajo mund të vihet në korelacion me një kundrinor të zhdrejtë parafjalor, plotësor kundrinor të argumentit (s'më vojt mendja për këtë (gjë)). Një e metë kryesore e autorit është se ai, është munduar t'ua përshtatë faktet gjuhësore të shqipes modeleve të gramatikave gjermane (shih parathënien, VIII); zaten, edhe shenjat e pikësimit ua ka përshtatur rregullave të gjuhës gjermane (ose të teksteve latine), gjë që është e papranueshme për sistemin objektiv të pikësimit në shqipen, si dhe për sistemin që është tani në zbatim. Në këtë çështje ai bën një hap prapa në krahasim me A. Xhuvanin. Nga ana tjetër ai saktëson trajtën e përdorimit të përemërit «lidhës» *kush*, cili shkon n'atë rasë qi e lypë kallxoja e vet, d.m.th. folja e fjalit, në të cillën është; pa e këqyrun rasën qi lypë kallxoja e fjalit, nga e cilla mvaret. Pra: *Kuj t'i kande* (ai të cillit t'i kande, t'i pëlqejë) *le të shkojë . . . Kuj* (ai të cillit) *i djegë miza* nuk ban za. (f. 71).

«Fjalia subjektore» e paraqitur nga K. Cipo<sup>4</sup> dallohet për informatat më të plota lidhur me rrethin e foljeve kallëzues të fjalive kryesore dhe me klasifikimin e tyre. Mjeteve të lidhjes të përmendur nga parashkuesit u shton edhe lidhëzën *në*; përmend edhe mënyrat e foljes kallëzues së fjalisë subjektore, saktëson më tej punën e shenjave të pikësimit, duke theksuar se «në qoftë se (fjalia subjektore) i del përpara kryesores, ahëre duhet ndarë kryesorja nga e varura me presë» (87). Një e metë kryesore është se fjalitë e varura që bashkohen me anën e «përemërit lidhor të pacaktuar» *kush*, që mund të zbërthehet: *ai që, ajo që* (f. 92) ai e shtie te «fjalia lidhore». Një gabim tjetër i K. Cipos është se «fjalinë lidhore» që ka të bëjë me një emër ai e konsideron si «subjektore, në qoftëse ky emër mund të shërbejë si kryefjalë e fjalisë me të cilën është lidhur. P.sh. *Puna që bëhet shkel e shko s'ka grat*. Në këtë periudë fjalia kryesore është: *s'ka grat*, dhe fjalia e nënvizuar është fjali lidhore subjektore» (f. 92).

M. Domi<sup>5</sup>, saktëson disi llojet e foljeve kallëzues të fjalisë kryesore, zgjeron numurin e tyre dhe sidomos zgjeron rrethin e mjeteve të lidhjes: përemëri a mbiemëri pyetës (*kush*, çfarë, cili) ose ndajfoljet pyetëse (si, qysh, ku, kur, pse (156) ose «ndonjë fjalëz (a, në) si dhe «përemërat lidhorë» *kush*, ç, *shka* (156) p.sh. Ç'erdh njëherë s'vjen përëherë (Sintaksa<sup>3</sup> (157). Në faqen 164 autori me të drejtë zgjeron mjetet e lidhjes me të tilla përemëra si *sa, gjithë sa*, por bën gabim duke quajtur përemëra lidhorë me kuptim të pacaktuar këto: *kushdo që, cilido që*. Këtu kemi përemërin lidhor *që* ndërsa përemërat e pakufishëm *kushdo, cilido* janë korelatët e tyre në fjalinë kryesore.

Stefan Prifti, në dispensën e vet për Institutet Pedagogjike Dyvjeçare<sup>6</sup> ka trajtuar më plotë se të gjithë parashkuesit fjalinë e varur kryefjalore. Në këtë dispensë shqyrtohen me të drejtë struktura e fjalisë kryesore dhe ajo e fjalisë së varur, llojet e ndryshme të mjeteve të lidhjes, mënyrët e foljeve kallëzues në të dy fjalitë, vendi i fjalisë kryesore në

4) K. Cipo, *Sintaksa*. Botim i Institutit të Shkencave. Tiranë, 1952.

5) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa e dytë, Sintaksa, Botim i parë, T. 1954, Botim i tretë (Sintaksa<sup>3</sup>), T. 1957.

6) Stefan Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Pjesa e II, disp. I, Tiranë, 1962.

periudhë, etj. Por aty ka dhe një varg gabimesh, pasaktësisht, kontradiktash që rrjedhin, sipas mendjes sime, nga vështrimi logjist i fakteve gjuhësore.

Autori konsideron gabimisht si identike kryefjalën dhe fjalinë kryefjalore. Kjo shihet nga synimi këmbëngulës për të treguar paralelizmin midis kryefjalës dhe fjalisë kryefjalore, ndonëse dhe vetë e sheh se «një ndrrim i tillë i fjalisë kryefjalore, dhe në përgjithësi i një njësie predikative në jo predikative, nuk është gjithmonë e mundur...» (97) Një gabim tjetër është ndarja e konstrukteve funksionalisht paralele në dy rubrika të ndryshme. Shembullin «Kush u nxitua, mori çalen grua» (109) autori e shtie te fjalitë kryefjalore, dhe me të drejtë, kurse shembullin «Ay që të bën të qajsh, ay të don» (142) te fjalitë «ndajshtimore caktore të ndërtuara me përemërat lidhorë që dhe i cili».

Ka dhe një varg pasaktësish, ndër të cilat do të përmendim.

Ndër foljet që mund të marrin fjali kryefjalore autori përmend ndër të tjera foljen *shkon, vete, bën* (99, pika 5) me shembëllën «Lidhje shqipëtarëvet nuk bën të jetë për pak kohë...» Në këtë shembëll fjalja «të jetë për pak kohë» nuk mund të jetë fjali kryefjalore ndaj pjesës tjetër, së paku, sepse kryesorja ka kryefjalën e shprehur, emërin «lidhja». Në fakt këtu kemi një kallëzues të përbërë ku folja *bën (nuk bën)* ka vlerë modale, dhe si rrjedhim s'kemi periudhë, por fjali.

Në faqen 99, ndër shprehjet e ndryshme (pika 7) autori përmend edhe të tilla si *vjen mirë, keq, rëndë, çudi*, etj. të cilat përbëkan kallëzues të fjalisë kryesore që kërkon kryefjalore, kurse në shënimin 4 të faqes 107 autori thotë me të drejtë se «nuk duhen konsideruar si fjali kryefjalore fjalitë shkakjore në rastin e foljeve e shprehjeve njëvetore: *më vjen keq, mirë, më vjen rëndë, më vështiret*, etj. P.sh. *Më vje keq që s'mëson*». Por në faqen 108, S. Prifti thotë se «... kur folja e këtyre fjalive është në lidhore apo në paskajore, atëhere ato s'janë më shkakjore por ruajnë funksionin origjinal të tyre: janë ndajshtimore caktore, ose marrin nuancë kushti, p.sh. «Nuk i vinte mirë të priste rrjedhen e ngjarjeve duarkryq» dhe «U ardhni keq të më zgjojnë». Autori është ngatëruar mjaft rëndë në interpretimin e fakteve gjuhësore.

Nga vështrimi kritik i shkurtër i trajtimit të fjalisë kryefjalore te autorët tanë del karakteri i pamjaftueshëm i studimit të konstrukteve «periudha me fjali të varur kryefjalore» në shqipen e sotme. Trajtimin e këtyre konstrukteve do të përpiqemi ta kryejmë në bazë të një konceptioni gramatikor unik: në qoftë se fjalja kryesore ka një kallëzues i cili merr në të vërtetë një kryefjalë kur ndodhet në fjalinë e pavarur, atëhere ndaj atij kallëzuesi mund të thuhet se një konstrukt predikativ luan një rol të ngjajshëm me atë të kryefjalës. Në ras të kundërt nuk mund të bëhet fjalë kursesi për një «fjali kryefjalore». Studimi mbështetet në materiale të bollëshme të letërsisë shqipe, prej Rilindjes e deri në ditët tona, si dhe në materiale të krijimtarisë popullore gojore.

### *Tre tipet strukturore të periudhës me fjali të varur kryefjalore*

Një nga çështjet më të ndërlikuara të periudhave është edhe çështja e klasifikimit të tyre. Klasifikimi i periudhave me fjali të varur në letërsinë gramatikore është bërë në bazë kriteresh të ndryshme, ndër të cilat tri janë kryesoret:

Periodhat janë klasifikuar: 1) Në bazë të mjetit të lidhjes ose të mungesës së tij: sipas lidhëzave, fjalëve lidhëse (periodhat sindetike) sipas intonacionit (pauzave, ngritjes e uljes së tonit) periodhat asindetike. Ky kriter nuk është zbatuar tek ne.

2) Në bazë të strukturës dhe të kuptimit njëkohësisht; ky është klasifikimi semantiko-strukturor; sipas këtij kriteri sapo kanë filluar studimet paraprake, dhe ai premt, sipas mendjes sonë, zgjidhje mjaft të frytëshme <sup>7</sup>.

3) Në bazë të funksionit logjiko-gramatikor adekuat të fjalisë së varur me një gjymtyrë përkatëse të fjalisë së pavarur. Ky kriter është më i përhapuri, ai është përqafuar edhe nga shkolla <sup>8</sup>. Në bazë të këtij kriteri do të trajtohet edhe tema: «Periodha me fjali të varur kryefjalore».

Prandaj objekti i studimit tonë përfshin ato konstrukte predikative të cilat janë korelative nga funksioni i tyre me atë të një kryefjale në një fjali të pavarur. Këtij parimi do t'i përmbahemi në mënyrë rreptësisht besnike dhe për këtë duhet së pari të shqyrtojmë, makar në mënyrë të përgjithëshme, marrëdhëniet midis kryefjalës dhe kallëzuesit në fjalinë e pavarur nga njera anë dhe marrëdhëniet midis fjalisë kryefjalore dhe fjalisë kryesore në periudhë.

Nga pikëpamja e trajtës gramatikore, fjalia ndahet në fjali dykryegjymtyrëshe, domethënë në fjali që i ka të dy kryegjymtyrët, dy gjymtyrët kryesore (kryefjalën dhe kallëzuesin) dhe në fjali njëkryegjymtyrëshe, domethënë në fjali që kanë vetëm një kryegjymtyrë, një gjymtyrë kryesore.

Paralelizmi midis fjalit kryefjalore dhe kryefjalës mund të bëhet, natyrisht, vetëm me fjalitë dykryegjymtyrëshe, tipet e tjera të fjalisë nuk hyjnë këtu, ndër të tjera, edhe fjalia pavetore.

Ç'është pra kryefjala? Gramatikisht, kryefjala është ajo kryegjymtyrë me brendi sendore, në rasën emërore pa parafjalë dhe që përcaktohet në mënyrë predikative nga kallëzuesi i cili shpreh një tipar, proces ose gjendje si diçka që buron prej kryefjalës <sup>9</sup>.

Në këtë përkufizim del karakteri korelativ i kryefjalës dhe kallëzuesit, dhe po të flasim në mënyrë rreptësisht shkencore në fjalitë njëkryegjymtyrëshe, me që s'ka kryefjalë s'duhet të thomi se ka kallëzues: e vetëmja kryegjymtyrë gramatikore ngërthen edhe treguesin për subjektin edhe atë për predikatin logjik <sup>10</sup>.

Kryefjala mund të shprehet me çdo pjesë të ligjëratës që tregon nocion sendor, substantiv ose të substantivuar krejt (ose deri diku); nga kjo pikëpamje, rasa emërore si rasë e substancës së pavarur, si në shqipet, ashtu dhe në gjuhë indoevropiane, është trajta tipike e kryefjalës. Kjo rasë emërore është absolutisht e pavarur, kurse rasa emërore e kallëzuesorit të kallëzuesit emëror tregon vartësinë e vet gramatikore nëpërmjet të trajtës së foljes këpujë.

**Kallëzuesi në shqipet paraqitet në trajtën e zgjedhuar të foljes (verbum**

7) Spiro Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*. Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike Nëntor 1962. Shaptillografuar në formë dorëshkrimi. T. 1962.

8) Spiro Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korelative*. Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 20-vjetorit të çlirimit. T. 1964. Dorëshkrim. Arkiv i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë.

9) Cf. B. Г. Адмони, *Введение в синтаксис современного немецкого языка*, Москва 1955, f. 50.

10) Idem, ibidem, 50

finutum), e cila mund të shprehë gjithë ato kategori gramatikore që sajojnë kallëzuesinë (predikativitetin): kategorinë e mënyrës, të kohës dhe të vetës; trajtat «e pashtjella» të foljeve nuk sajojnë kallëzues, edhe sikur ky të mbiquhet «i pashtjellë» 11.)

Në gjuhësi, linguistë të tillë si V.A. Bogorodickij<sup>12</sup>, E. Sepir (Seppear)<sup>13</sup> kanë treguar nevojën për të caktuar tipe të veçantë fjalish simbas dallimeve që kanë nga pikëpamja e brendisë së përgjithësuar logjike dhe e trajtës gramatikore. Kështu pra A.V. Bogorodickij ka paraqitur tri tipe kryesore fjalish simbas «karakterit të tipareve që shprehen nga kallëzuesi dhe që i vishen kryefjalës:

1) Tipi i fjalisë që paraqit fakt, domethënë çka vrejtohet, p.sh. «Kali po ecën»;

2) fjali ku përcaktohet kryefjala nga pikëpamja e nocionit të llojit, farës;

3) fjali ku përcaktohet kryefjala nga pamja e cilësisë.

Tipet gramatikore të fjalisë dallohen para së gjithash nga trajtat e shprehjes së kallëzuesit, të cilat shërbejnë si mjet për një dallim të tillë, shumë më të qartë dhe mjaft të laryshëm se sa kryefjala: fjalë që tregon «send» në rasën absolutisht të pavarur, në «emërore». Natyrisht një kallëzues i caktuar varet nga brendia reale e një kryefjale të caktuar, sepse raportet kallëzuesore synojnë gjithëmonë të shprehin marrëdhënie reale midis sendeve dhe fenomeneve.)

Simbas marrëdhënieve midis kallëzuesit dhe kryefjalës kemi:

1) marrëdhënie midis vepruesit (agentit) dhe veprimit (me kuptim të përgjithshëm) ose marrëdhënie midis bartësit të gjendjes (kryefjalës) dhe gjendjes.

2) marrëdhënie midis cilësisë dhe bartësit të cilësisë, ku bartësi i cilësisë shprehet nga kryefjala, kurse cilësia me pjesë të ligjëratës së specializuara për këtë, sidomos me mbiemra ose pjesore të adjektivizuara. Kallëzuesia në këtë rast shprehet me folje që kanë kallëzuesi të paplotë (verba essendi) ose folje të tjera që mund të shërbejnë si këpujë midis kallëzuesorit (predikativit) dhe kryefjalës dhe që shprehin kategoritë e mënyrës, kohës dhe vetës.

3) marrëdhënie midis të veçantës dhe të përgjithshmes, si dhe marrëdhënie të identitetit.

Në çdo tip fjalie shprehet marrëdhënia e së veçantës dhe e së përgjithshmes, uniteti i tyre dialektik. Në punimin «Rreth çështjes së dialektikës<sup>14</sup>», V.I. Lenini shkruan «Të fillojmë nga më e thjeshta, më e rëndomta, më masivja etj., nga një fjali çfarëdo: fletët e drurit janë të gjelbra; Ivani është njeri; Zhuçka është qen etj. Që këtu, siç e vuri në dukje në mënyrë gjeniale Hegeli, kemi dialektikë : e veçanta është e përgjithëshme» Pra, të kundërtat (e veçanta e kundërt me të përgjithëshmen) janë identike: e veçanta nuk egziston veç se në lidhjen që çon tek e përgjithëshmja. E përgjithëshmja egziston vetëm tek e veçanta, nëpërmejt së veçantës. Çdo e veçantë është (në një mënyrë ose në tjetrën) e përgjithëshme. Çdo e përgjithëshme është (pjesëzë ose anë ose esencë) e së veçantës. Çdo e përgjithëshme nuk përfshin veç se

11) Për kritikën e «fjalive të pashtjella» shih kumtesën (7)

12) A. В. Богородицкий, Общій курс русской грамматики, Botim i pestë. М.—Л. 1935, fq. 213.

13) E. Seppear, *Language*, apud. W. Admoni, der Deutsche Sprachbau, Leningrad, 1960, fq. 213.

14) В. И. Ленин «К вопросу о диалектике», in „Философские тетради, Сочинения, Изд. четвертое, Том 38, М. 1958, стр. 359.

në mënyrë të përafërtë gjithë sendet e veçanta. Çdo e veçantë përfshihet në mënyrë të paplotë tek e përgjithëshmja etj. etj. Çdo e veçantë është lidhur me mija tranzicione me sende, fenomene, procese të veçanta të një lloji tjetër etj. Q y s h k ë t u kemi elementet, fillesat, e nocionit d o m o s d o s h m ë r i, të lidhjes objektive të natyrës etj. E rastëshmja dhe e domosdoshmja, fenomeni dhe esenca ndodhen që këtu, sepse kur themi: Ivani është njeri, Zhuçka është qen, kjo është gjethe druri etj. n e h e q i m m ë n j a n ë një varg tiparesh, si të rastëshme, ne dallojmë esencialen nga ajo që çfaqet dhe i vemë përballë njëra tjetrës.

Kështu pra në çdo fjali mund të zbulojmë (dhe duhet të zbulojmë), porsì në «qelizë» gjithë fillesat e gjithë elementeve të dialektikës, duke treguar kështu se gjithë të njohurit e njeriut e ka të vetën dialektikën».

Le të shqyrtojmë tani çështjen e periudhës me fjali të varur kryefjalore.

Gjymtyrët përbërëse të periudhës (njësitë predikative që ngërthejnë një *verbum finitum*, fjalitë) janë lidhur në mënyrë dialektike midis tyre: fjalia e varur quhet fjali e varur kryefjalore sepse ajo bën një funksion adekuat (por jo identik) me funksionin e një kryefjale ndaj foljes kallëzues së fjalisë kryesore. Prandaj do të kemi fjali të varur kryefjalore sa herë që njësia kallëzuesore (fjalia e varur) do të ketë të bëjë me një njësi tjetër kallëzuesore (fjalinë kryesore) që ka si kallëzues një folje që edhe përbrenda një fjalie të pavarur do të mund të mirte një kryefjalë. Në rast se folja e fjalisë kryesore nuk është e tillë që të marrë një kryefjalë, nuk do të kemi atë paralelizëm sintasor-funksional në bazë të të cilit është klasifikuar fjalia e varur kryefjalore në periudhë. Përfundohet pra mundësia për të pasur fjali të varur kryefjalore ndaj një foljeje pavetore përbrenda fjalisë së pavarur.

Prandaj është e udhës të shqyrtohen periudhat me fjali të varur kryefjalore në bazë të tri tipeve kryesore të fjalive «simbas karakterit të tipeve të shprehura nga kallëzuesi dhe që i vishen kryefjalës».

Nga brendia e tyre periudhat me fjali të varur kryefjalore do të shihen sipas marrëdhënieve që shprehen në to:

1) marrëdhënie midis procesit dhe bartësit të procesit (kallëzuesi i fjalisë kryesore është kallëzues foljor);

2) marrëdhënie midis cilësisë dhe bartësit të cilësisë; (kallëzuesi është emëror me një kallëzuesor mbiemër);

3) marrëdhënie midis së veçantës dhe të përgjithëshmes, si dhe marrëdhënie të identitetit (kallëzuesi emëror ka një kallëzuesor të shprehur me emër).

Në periudhë secila prej të dy gjymtyrëve shprehet me fjalitë përkatëse.

Për periudhën me fjali të varur kryefjalore (si dhe për disa tipe të tjera të periudhave me fjali të varur) faktori vendimtar kryesor që krijon funksionin e caktuar të fjalisë së varur është struktura e vetë fjalisë kryesore, ndërsa struktura e fjalisë së varur nuk ka aq rëndësi, sepse ajo është e kushtëzuar nga kryesorja. Struktura e fjalisë kryesore ka laryshi të madhe.

Së pari, në fjalinë kryesore *munjon* kryefjala dhe fjalia e varur bën ndaj kallëzuesit një funksion analog me atë të një kryefjale të zgjeruar.

Së dyti, në fjalinë kryesore ndodhet një kryefjalë gramatikore, por kjo kryefjalë është shprehur me fjalë që nuk tregojnë nocione sendore,

që nuk emërtojnë (me përemëra, sidomos dëftorë dhe të pakufishëm); këta përemra pa fjalinë e varur nuk kanë brendi reale konkrete dhe vetëm nëpërmjet të fjalisë së varur deri diku konkretizohen.

Këndeje rrjedhin dy veçoritë kryesore të periudhës me fjali të varur kryefjalore dhe dallohen dy tipet strukturore kryesore të periudhës me fjali të varur kryefjalore:

*tipi i parë*: fjalisë kryesore i mungon kryefjala dhe punën analoge të saj e kryen fjalia e varur drejtpërdrejt;

*tipi i dytë*: fjalia kryesore ka një kryefjalë, por ajo nuk emërton (nuk shpreh nocion sendor) dhe fjalia e varur, duke përcaktuar atë kryefjalë përemërore, e mbush atë me brendi reale konkrete dhe nëpërmjet të saj, të rthorazi luan funksionin e një kryefjale. Këto ndryshime kryesore në strukturën e periudhës shoqërohen edhe me ndryshime të tjera esenciale në shprehjen e kallëzuesve të fjalisë kryesore, në llojet e mjeteve të lidhjes midis fjalisë së varur dhe asaj kryesore dhe zaten edhe në vetë brendinë reale të fjalive përbërëse të periudhës dhe të marrëdhënieve kuptimore të shprehura midis tyre.

1) Tipi i parë përfshin ato periudha që nuk kanë në fjalinë kryesore ndonjë kryefjalë (kryefjala mungon) dhe kallëzuesit e tyre janë foljorë ose emërorë. Kur kallëzuesi është foljor, shprehet me folje të një kuptimi të caktuar leksikor, numuri i të cilave është relativisht i kufizuar; trajtat e foljeve kallëzues janë në vetën e tretë njejës. Këto janë folje kalimtare pësore që tregojnë:

- a) të kumtuar (verba declarandi)
- b) të perceptuar shqisor;
- c) të perceptuar mendor;
- ç) proces të menduarit a vlerësim subjektiv;

Në këtë rast fjalia e varur bashkohet me kryesoren me anën e lidhëzave *se, që, sikur, kur* etj, me anën e përemërave pyetës lidhorë dhe ndajfoljeve pyetëse lidhore, si dhe me anën e pjesëzave *a, mos* që shndrohen përbrenda periudhës në lidhëzat përkatëse *a, (se)mos* dhe të lidhëzës *në(nëse)*.

d) dëshirë ose shprehje të vullnetit, dhe fjalitë e varura bashkohen me kryesoren drejtpërdrejt me anën e trajtave të lidhore së kallëzuesit, dhe veç kësaj mund të marrin edhe lidhëzën *që*.

e) Kallëzuesi foljor mund të shprehet edhe me folje jokalimtare, në numur të kufizuar, me kuptim leksikor të caktuar si folje që tregojnë të ndodhur (ndodh, etj.), të pëlqyer (më)pëlqen, të konkluduar del(rezulton) të mjaftuar (mjafton), si dhe (më) takon, (s)më mbetet, etj. etj. Mjetet e lidhjes së fjalive të varura mund të ndryshojnë: *se, që* plus kallëzues në dëftore etj. ose vetë mënyra lidhore plus *që*.

Kur kallëzuesi është emëror, pjesa më e madhe e tyre përbëhet prej foljes këpujë jam plus një emër, një mbiemër. Mjetet e lidhjes si dhe mënyra e kallëzuesit mund të jenë të ndryshme sipas modalitetit leksikor të fjalisë kryesore, ose sipas modalitetit të vetë fjalisë së varur.

Këtu përfshihen dhe ato periudha të përbëra prej një kryesoreje dhe prej një kallëzuesoreje, a kundrinoreje ku fjalia kryesore përfaqësohet gjithsejt prej foljes këpujë jam (është, ishte, etj) ose prej shprehjes domethënë të shndruar në këpujë ose prej togut *do të thotë* te periudhat që venë shenjën e barazisë midis kryefjalores dhe kallëzuesores, a kundrinore në «periudhat e identitetit» si p.sh.: Të duash komunizmin domethënë të jesh ca komunist... Çlir. (I) (99)/. Këto periudha përfshijnë tipet

semantiko strukturore fthillëzonjës dëftorë, urdhërorë dhe ata pyetës-habitore<sup>15</sup>.

2) Tipi i dytë semantiko-strukturor i periudhave me fjali të varur kryefjalore përfshin ato periudha që kanë në fjalinë kryesore një kryefjalë gramatikore të shprehur me përemërat dëftorë *ai, ajo, ata, ato* ose me përemërat e pakufishëm të gjithë, të gjitha, *kushdo, cilido, çfarëdo* dhe shumë rrallë *çdo*, të gjithë në rasën emërore pa parafjalë. Foljet kallëzues të fjalisë kryesore nuk kanë asnjë kufizim nga pikëpamja semantike, atje mund të përdoren në të gjithë vetat dhe numurat të gjitha foljet (a këpujat) që mund të marrin një kryefjalë të shprehur me përemër; ky tip dallohet edhe nga mjetet e lidhjes: fjalia e varur bashkohet nëpërmjet të përemërit lidhor *që* (fort rrallë *i cili*, etj.) kur ka si korelat të gjithë përemërat e mësipërmë përveç përemërit të gjithë, të gjitha, të cilët janë korelatë të përemërit *sa* ose *ç*, që përmbushin edhe rolin e një përemri lidhor. Këto periudha përfshijnë tipet përemërore korelative<sup>16</sup>.

3) Midis këtyre tipeve kryesore qëndron edhe një tip tjetër që do ta quajmë *tipi kalimtar*, i cili ka disa tipare të tipit të parë dhe disa tipare të tipit të dytë. Me tipin e parë i bashkon fakti se fjalitë e varura bashkohen drejtpërdrejt me një kryesore ku mungon kryefjala (sepse mjetet e lidhjes nuk kanë ndonjë korelat përemëror në fjalinë kryesore, ose ai është shkrirë në një shprehje përemërore lidhore), kurse me tipin e dytë i bashkon fakti që kallëzuesi i fjalisë kryesore nuk ka kufizime nga pikëpamja e kuptimit semantik, ashtu si ndodhte edhe në tipin e dytë. Këto fjali të varura bashkohen me kryesoren me përemërat e pakufishëm lidhore *kush, ç, çka (shka), sa* si dhe shprehjet përemërore *gjithë sa, gjithë ç*, të cilët janë tashmë shkrirë në një tog për shkak të humbjes së pavarësisë sintaksore të përemërit në trajtën *gjithë*, i cili nuk përdoret veçmas si i substantivuar. Këtu hyjnë tipet përemërore jokorelative.

## 1.1. PERIUDHAT E TIPIT TË PARË

### I. 1. Tipi lidhëzor fthillëzonjës (dëftor dhe urdhëror)

Këto periudha dallohen nga disa karakteristika të veçanta:

a) Mjetet e lidhjes së fjalisë së varur me kryesoren janë lidhëzat fthillonjëse *se, që*, lidhëza *sikur* dhe në raste më të rralla lidhëza kohore *kur* (që funksionon si lidhëzë fthillonjëse), si dhe ndajfolja lidhëzore *si*, që në kontekst të caktuar funksionon si lidhëza kushtore-fthillonjëse *se, që*. Për mjetet e lidhjes do të bëhet fjalë veçanë në kapitullin përkatës të pjesës së dytë të këtij punimi.

b) fjalia e varur, kryefjalore nga struktura e periudhës, përbën nga brendia reale konkrete, fthillëzimin e gjymtyrës kryesore kallëzuesore të fjalisë kryesore: ajo tregon brendinë e një fjale me kuptim të caktuar leksikor: kuptim, perceptim, proces të të menduarit, dëshirë a vullnet, ose përbën një thënie që vlerësohet nga një pikëpamje e caktuar prej fjalisë kryesore;

c) kallëzuesit e fjalisë kryesore, foljorë ose emërorë) kanë një folje (ose këpujën) *domosdo* në vetën e tretë njejës;

15) Cf. Spiro Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korelative*, fq. 2 vv.

16) Idem, ibidem, fq. 3 vv.

ç) kallëzuesit foljorë mund të jenë shprehur me folje kalimtare të diatezës pësore dhe, më rrallë, të diatezës veprorë, ose mund të jenë folje pakalimtare, ndërsa kallëzuesit emërorë kanë si kallëzuesorë emëra, mbiemëra dhe si këpujë, në shumicën dërmuese të rasteve, foljen maksimalisht të abstraguar *jam* (v. e tretë njejës -*është*) dhe më rrallë ndonjë folje tjetër që ka ruajtur akoma një pjesë të kuptimit leksikor (*bëhet, duket, del, etj.*). Rastet e togjeve *është + ndajfolje* duhen përjashtuar nga rastet e një kallëzuesi që kërkon domosdo fjali të varur kryefjalore, sepse nuk vihet dot një bashkëlidhje e drejtpërdrejtë midis tyre dhe ndonjë kryefjale gramatikore. Këto togje janë më fort shprehje pavetore, dhe si të tilla nuk marrin dot as kryefjalë as fjali të varur kryefjalore: këto mbeten jashtë tipeve të periudhës me fjali të varur kryefjalore.

**I.1.1.** Kallëzuesit e fjalisë kryesore të shprehur me folje kalimtare të trajtës pësore dhe me kuptim të caktuar leksikor, përbëjnë një grup të kufizuar; ato tregojnë: të komunikuar, të perceptuar, proces të të menduarit (të vlerësuar), dëshirë a vullnet.

**I.1.1.1.** Foljet e të kumtuarit janë të pakta.

Nga foljet që tregojnë të komunikuar (nëpërmjet të ligjërit ose me ndonjë nuancë të mënyrës së të komunikuarit) si kallzues i fjalisë kryesore në periudhën me fjali kryefjalore përdoret një numur mjaft i kufizuar: *thuhet, flitet, pëshpëritet, përmendet, komunikohet, rrëfëhet, vërtetohet, provohet, shkruhet*. Veç kësaj, nuk ka vetëm kufizime në lidhje me rrethin e foljeve kallzues, por edhe me trajtat kohore të foljeve, si dhe të mënyrëve. Trajtrat kohore më të përdorëshme janë: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera; duhet theksuar se çdo folje nga ato të lartpërmendurat nuk përdoret në të gjitha këto trajta kohore, por kush më tepër në njerën trajtë kohore, kush më tepër në tjetrën; zaten, ka ndonjë që përdoret edhe në një trajtë kohore të vetëm.

Trajtat kohore kryesore të përdorimit të saj janë: e tashmja dhe e pakryera; trajtat e tjera, ndonëse të mundëshme, përdoren jashtëzakonisht rrallë.

Shpesh herë vetë folja *thuhet* përbën gjithë fjalinë kryesore:

Thuhet se 1800 vjet para K., Egjiptënë e zunë ca tufë barinjsh, dhe e mbajtën 150 vjet. / Naim Fr.: IeP për mës. të para (12) /

Thuhetë se në kohët të vjetëre kanë mbretëruarë 30 fëmijë mbretësh n'Egjiptë. / Idem, ibidem (12) /

/... priftërit'e tyre / e Babillonasve, S.F. / thuheshin Haldenj / Thuhetë se këta Haldenjët kanë gjeturë herën'e parë të parat'e diturisë së qiellshkronjës. / Idem, ibidem (16)

Thuhet se sivjet do të kemi dimër. / K. Cipo: Sintaksa (86) /

Në kry t'kalasë asht kulla e sahatit. Thohet se ky sahat ka pasë qenë në në kohën e Skenderbegut. / KPHs (51) Krujë /

Përsipërë këtyre gjendetë Kasht'e Kumtërit rreth-e-rrotullë; thuhet që ajo Kasht'e Kumtërit është një remet yjsh të largë... / Naim Frashëri: Dituritë. (122) /

Thuhetë që Ilyrianët ishin shumë t'afërë me Maqedonasit e Thrakasit me Frygasitë; po të tërë ishin një komp, edhe kupëtoj(i)në gjuhën e njëri-tjetrit. / Sami Frashëri: Shqipëria<sup>6</sup>... (7) /

Kështu Karaxha Beu u këthye në Stamboll me humbje të paka, dhe thuhet që Sulltan Mehmedi e përgëzoj... / Noli: Hes<sup>2</sup>(96) /

Edhe kur flasim për qarkore e urdhëresa ministeriale etj. s'ka vënt për shkallë krahasore, sepse nuk thuhet dot që kjo urdhëresë është më ministeriale nga ajo. / Cipo: Gramatika (76) /

Rrallë në fjalinë kryesore mund të ndodhet edhe ndonjë fjalë e cila shërben për të bërë një farë lidhjeje me sa janë thënë më parë, ose shërben për të treguar karakterin e saktësisë, vërtetësisë së asaj që komunikohet në fjalinë e varun:

*Andaj* thuhetë se njeriu ka dalë të parënë herë në malet të Persisë... / Naim Frashëri: IeP (6) /

Sot dituritë [i] nxuarrë Shqipëtarëtë të vjetërë edhe u rrëfye *faqeza* q'Elinëtë janë të mbledhurë prej Egjypte, prej Finiku... / Naim Frashëri/.

Kallzuesi *flitet*, *pëshpëritet*, etj. rrallë mund të përbëjë tërë fjalinë kryesore; më të shumtat e herëve në fjalinë kryesore ndodhen gjymtyra të dyta, kryesisht plotësorë të vendit.

/ Delia: / flitet se vetë pasha i ka ftue / shaljanët S.F. / me folë me ta...

/ Delia /... Burra, flitet se edhe i ka mbytë. / Luca: Shtatë shaljanët (11)

Flitet që iku djali. / Sheperi: Sindaksa (190) /.

Pëshpëritet se kanë gjetur gjëra të vyera në një varr.

/ Cipo: Sintaksa (39) /

Leksi kish folë për masa e menjëherëshme që duheshin marrë. Mustafai i kish treguar se përshpëritej që komunistët po përpiqeshin të formojnë partinë. / Shuteriqi: Çlir. (I) (253) /

Plotësorët e vendit që përdoren më shumë në fjalinë kryesore shprehen dëndur me konstrukte që tregojnë një vend pak a shumë të pacaktuar (posht'e e lart), ose përmendin një send i cili shërben për një përcaktim më të mirë hapësiror të vendit ku «komunikohet» brendia e fjalisë së varur kryefjalore.

Hamza Kastrioti, si u kthye në Krujë, vuri tërë forcën që t'i ndjehej faji, (,) dhe flitej *lart e poshtë* që Skënderbeu do t'a falte si Moisinë, a të paktën do t'a çlironte si Gjergj Stres Ballshën. / Noli: HeS<sup>1</sup>, III /

Flitej *posht'e lart* se do të kemi ca të papritura të bukura. / Cipo: Sintaksa (39) /

Përshpëritet *posht'e lart* se sivjet do të kemi një eklips të diellit, d.m.th. do të zihet dielli. / Idem, ibidem (61) /

Flitet *andëj nga qyteti* se po i bëjnë fertele tregëtarët e mëdhenj... / Spasse: Afërdita... (V..) /

Atë natë Tonçi s'ish dukur fare. Në *fshat* flitej se e kishin parë me dyfek në krah. / Dushi: UeV, I, 1 /.

Do të kalojn vitet, por në *histori*

Ka me u përmend se një popull trim  
rrethuar nga armiqt, thell'në mbrapavi,  
ka mbrojtun dikur paqen me guxim,

ka ngritur socializmin me besim! / Ll. Siliqi: Lavdija, Sheqeri i parë /

Si përcaktues të vendit mund të përdoren edhe ndajfoljet:

Më *lart* u tha se në pesëvjeçarin e parë... prodhimi bujqësor është zhvilluar me një ritëm mesatar prej 6,5 përqind. / M. Shehu: Raport Kg. III (17) /

Ke kodra Kryshkozës ka pasë nrefë topat Sulltan Murati qi ka rafë kalanë e Krusë. *Ktu, në Kru*, Folet se janë 366 tyrbe. / KPHs (51) (Krujë) /

Në këtë shëmbullin e nxjerrë nga folklori, fjalët, *këtu, në Kru* janë pjesë të fjalisë kryesore në qoftë se ato do t'i lidhnim me vendin ku ndodh

të komunikuarit; por në qoftë se ato kanë të bëjnë me vendin ku ndodhen tyrbet, periudha do të përbëhej prej një fjalie dëftore, kurse *folet* do të përbënte një fjali ndërmjetëse me një përdorim abuzif të lidhëzës *se*.

Ja edhe një shëmbull me ndajfoljen lidhore *ku* si plotësor të vendit:

Mjaftonte, fjala vjen, që xhandërmarija ose komuna të vuloste një shkresë, *ku* të vërtetohej se filani, që s'kish bërë asnjë karroqe misër e asnjë top duhan, paska bërë aq e aq. / Shuteriqi: Çlir. (II) (II, 2... /

Në disa folje të tjera ruhet edhe më qartë karakteri kalimtar i foljes: pranë kallzuesit përdoren gjymtyrë të dyta të përbëra prej emrash me parafjalën *nga* ose *prej*, të cilat kanë për funksion të tregojnë subjektin logjik të komunikimit, që shënohen në sintaksat shqipe me termin «plotësi i vepruesit».

... *Nga arshivat* zyrtare të Republikës Veneciane provohet katërçipërisht që Skënderbeu s'ia la Krujën dhe mbretërin' e tij Venetisë as përpara (,) as pas vdekjes së tij, as me traktet (,) as me testament... / Noli: HeS<sup>1</sup>, Hyrje, II /.

Që Skënderbeu në këtë kohë ishte shumë i ri, afro tridhjet'e dy vjetsh, provohet *nga fjalët* me të cilat i drejtohen krerët në Kuvënt të Leshit, pas Dhimitër Frëngut, kur e emërojnë kryekumandar:... / Idem, *Ibidem*, I /.

Të gjithë partizanët ndjenë një gëzim të papërshkrueshëm kur iu komunikua *nga komanda* se misioni kishte mbaruar dhe tash do të ktheheshin në jugë. / M. Shehu: *Kujtime* 2... (35) /.

Plotësorët e vendit, si dhe «plotësat e vepruesit» janë disa tregues që dëftojnë se tek këto folje ndjehet qartë karakteri kalimtar: më qartë te konstruktet me plotësa të vepruesit, më pak qartë tek ato me plotësorë të vendit. Ndërsa tek të parët tregimi i vetës bëhet nëpërmjet të konstruktit me parafjalë ndaj një foljeje kalimtare pësore, tek të dytët tregimi logjik i vetës bëhet në mënyrë të mjegulluar, nëpërmjet të përmëndjes së një hapësire vendore (sidomos qytet, fshat, etj.) të cilat tregojnë me anën e një farë të qekuri të largët dhe të tërthortë vetët (banorët) të cilëve u përkasin komunikimet e përmbajtur në fjalinë e varur. Krahaso: *Flitet* andej nga qyteti, nga fshati, në qytet, në fshat, ku emri që tregon hapësirë të shtie në mendim njerëzit që ndodhen në atë hapësirë e të cilët janë subjekt logjik i thënies.

1.1.1.2. Prej grupit të foljeve që tregojnë të perceptuar shqisor, si kallzues i fjalisë kryesore përdoret vetëm shprehja foljore *vihet re*, dhe folja *ndihet*, të cilat kanë trajtat korelative veprorë: *vë re*, *ndiej*. Folja *shihet* rrallë përdoret si trajta pësore e foljes *shoh*, prandaj për trajtën pësore me funksion vetor — njëvetor(\*) përdoret folja *duket*, e cila nga ana e saj nuk ka trajtën veprorë *duk*. Ndërsa folja *dëgjoj* ka trajtën pësore *dëgjohet*: *dëgjoj muzikën*; *dëgjohet zhurma*, por përbrenda periudhës, folja *dëgjohet* si kallzues sundon një fjali të varur të bashkuar me lidhëzën *sikur* ose me ndajfoljen *pyetëse si*.

Ndërsa *vihet re* mund të përdoret si kallzues i fjalisë kryesore në trajtat kohore të së tashmes, të së pakryerës, të së kryerës së thjeshtë dhe të kryerë, trajta *ndihet* përdoret rrallë në kohën e kryer.

(\*) Funksion vetor tregojmë përkitasi që një folje mund të marrë si kryefjalë një emën (të përemër) në njëjës dhe shumës, kurse me funksion vetor, kur merr vetëm një kryefjalë në njëjës.

Kështu, që tani po vihet re se Shtetet e Bashkuara po humbasin pak nga pak monopolin e viteve të para të pasluftës... / E. Hoxha: Rap.

Kg. III

«Zoti ju vraftë, more Agët e Jutbinës!

Po ku a ndie n'mjet tokës e t'qiellës

se muer vllau motrën e vet?» (KPLgj: Martesa e Halilit).

Për të treguar se brendia e fjalisë së varur është diçka që perceptohet prej dikuj të shprehur në fjalinë kryesore me një emër a përemër në rasën dhanore në gjuhën shqipe përdoren shprehje foljore të përbëra prej një foljeje jokalimtare me kuptim të lëvizjes (kryesisht folja *bie*) prej emërit që tregon organin përkatës të shqisave (*sy, vesh*) me parafjalën *në*, pra: *më bie në sy, më bie në vesh*. Këto folje tregojnë se personi a sendi i shprehur me emër a përemër në dhanore është ai që pëson një mbiveprim mbi shqisën përkatëse nga ajo që thuhet në fjalinë e varur.

*Dokës i ra në sy menjëherë se Marku ish ligë mjaft.*

/ Shuteriqi: Çlir. (I) III, 1... /

Organizatës bazë i kishte rënë në sy se kryetari sikur nuk po bënte punë të paqme këto ditë. / Spasse: Buzë Liqenit, «N» 3/1961/

Kohët e fundit *Stefanicës i* kishte rënë në vesh se i shoqi i Afërditës qënka gjallë. / Spasse: Afërdita... III /

I.1.1.3. Pak më tepër përdoren si kallzues së fjalisë kryesore trajtat pësore të foljeve që shprehin të perceptuar mendor, proces mendor si: të kuptuar, të marrë vesh, të ditur, të kujtuar, të besuar, të supozuar, pra: *kuptohet, merret vesh, dihet, besohet, zihet* (më) *kujtohet* si dhe shprehjet foljore të pandashme *bie ndër mënd, shkon ndër mënd, s'do mënd*, etj.

Kallzuesit (e përbërë prej një foljeje të vetme, si *kuptohet, dihet, besohet, zihet* (zehet), si dhe shprehje *merret vesh* kanë si korelative trajtat veprorë të foljeve përkatëse, kështu që në periudha ato paraqiten me funksion njëvetor; ndërkaq, folja *kujtohet* mund të ketë edhe trajtat vetore në pësore: (*unë*) *kujtohem*, (*ti*) *kujtohesh*, etj. kështu që te shëmbulli: *Unë u kujtova vonë se pasdreke kishim mbledhje*», folja *u kujtova* ka si kryefjalë vetën e parë njejës *unë*, pra ajo është vetore (kalimtare indirekte; u kujtova për mbledhjen) ndoffa me nuancë vetvetore, kurse në rastin tonë kallzuesi *kujtohet* kërkon domosdo një emër, përemër në rasën dhanore i cili të shprehë subjektin logjik që pëson mbiveprimin e asaj që thuhet në fjalinë e varur; kështu pra kemi opozicionin: *kujtoj shtëpinë — më kujtohet shtëpia*, dhe në sajë të korelacionit kryefjalë-kallzues në fjalinë e thjeshtë del edhe funksioni kryefjalor i fjalisë së varur në një periudhë që ka si kallzues këtë folje.

Ashtu si dhe për rastin e kallzuesit *thuhet*, kështu edhe për kallzuesin *kuptohet*, mund të themi se mjaftojnë vetëm këta për të formuar tërë fjalinë kryesore; fjalia kryesore mund të përmbajë në mjaft raste përcaktorë të mënyrës së shtjellimit të procesit të të kuptuarit, plotësa mënyre të shprehur më të shumtën e herës me ndajfoljet *lehtë, fare lehtë, sheshit, faqeza, vetiu, pa dyshim*, etj.

*Kuptohet* se vetëm duke krijuar ferma të mëdha blegtorale në kooperativat bujqësore do të bëhet e mundur që ne, brënda pak vjetëve, të shtojmë në mënyrë të dukëshme prodhimin e mishit e të qumështit.

/ E. Hoxha: Mbi masat... (26) /

*Kuptohet* se grumbullimi i mishit të kish qënë shumë më i madh nga shtimi i popullsisë. / Idem, ibidem (11) /.

[Në muhabet dhe në këngë përzihen dhe gratë...] Kuptohet se shumica e tyre janë delegatë si unë e Xhezua. / Musaraj: Isha unë (35) /

817 / Këto katërë copë të kohës së njëmbëdhjetë të dheut janë xgjaturë me mijëra vjet. / Andaj kupëtohet që njeriu ka shumë mijëra vjet, që gjëndetë mbi dhet. / Naim Frashëri:

818 Kuptohet *lehtë* se qarqeve imperialiste agresive të perëndimit nuk u ka ardhur aspak mirë që një vënd i vogël si Shqipëria të fitonte pavarësinë dhe sovranitetin, të shpallte republikën dhe të vendoste regjimin e demokracisë popullore. / Hoxha: Kg III ( ).

/ — Ç'të tha babaj, more djalë?

— Më tha që të punoj ca më shumë për të mirën e shoqërisë /. Gjithashtu edhe te periudha «më tha që të punoj (ca) më shumë» nuk është zënë në gojë (kryefjala, S.F.), sepse kuptohet *fare lehtë* se është babai. / Cipo: Sintaksa (62) /

Kallzuesi *nënkuptohet* nuk ka nevojë për cilësimin e procesit, sepse ai është shprehur me kuptimin leksikor të foljes, por mund të ketë gjymtyrë të dyta që tregojnë burimin e dijes.

... Nënkuptohet që Skënderbeu ishte në marrëveshje me Huniadin dhe përandaj ky guxoj të mernte ofensivën me një ushtëri aq të vogël. / Noli: HeS, I /

Kallzuesi i fjalisë kryesore mund të vihet edhe në trajta të mënyrave të tjera. Po apim dy shëmbuj me kallzuesin e fjalisë kryesore në lidhore, njëra e pavarur, tjetra e varur nga fjalia e mëparëshme:

819 Kur themi: gjëmon deti, të mos kuptohet se kemi radhitur dosido, një emër, një nyje dhe një folje. / Cipo: Sintaksa (3) /

Kantakuzëni nuk na thotë se ku e ka marrë informatën e origjinës sllave të Kastriotëve, po duket që e ka hequr nga Mati, të cilin Barleti e quan me emërin klasik të Maqedonisë Aemathia *dyke lënë të kuptohet* që Kastriotët Matjanë ishin Sllavë të Makedonisë. / Noli: HeS<sup>2</sup> (14-15) /

Shprehja foljore *merret vesh* mund të shërbejë si kallzues i fjalisë kryesore sa herë që kjo është korelative me *marr vesh*: kallzuesi është më shumë «pavetor» kur vetë përbën gjithë fjalinë kryesore; por nuk duhet ngatërruar me vetën e tretë të shprehjes foljore *merrem vesh* (*si merret vesh*) sepse në këtë rast jo vetëm që ai është vetor-reciprok por edhe kuptimi i tij është krejt ndryshe: *bie dakord*, *bie n'ujdi*. Shprehja foljore *merret vesh* nga pikëpamja leksikore dhe gramatikore është sinonimike me foljen *kuptohet* të përdorur si kallzues të fjalisë kryesore dhe përbën vetë ajo tërë këtë fjali.

Nga ana tjetër, *merret vesh* fare shkoqur që ky bir, cilido që ishte, merrte urdhër më tepër nga Gjon Kastrioti se nga Sulltani.

/ Noli: HeS<sup>2</sup> (17)

820 — E? Si thua ti? Pse t'u xhvesh para syve dhe pastaj e gjete në dyshek?

— Se është kurvë... /

821 — U muarr vesh që është e tillë. / Po, pa shiko se mos ka edhe ndonjë bisht prapa / / Gjata: Këneta (387) /

Kallzuesi *merret vesh*, kur është i shoqëruar nga gjymtyrë të dyta me funksionin e plotësit të vendit (a të «*burimit*») tregon burimin e bren-disë së thënies së fjalisë së varur kryefjalore, ka më shumë kuptimin e perceptimit të një njohurie, perceptim që kryhet nëpërmjet të mbiveprimit

Shenjat e pikësimit e vendosura në parentez, p.sh. (.) ose mungesa e shenjës brenda parentezit ( ); tregojnë përkritasi se duhet ajo shenjë ose jo.

të gjymtyrës së dytë. *Merret vesh* ka kuptimin pësor të shprehjes foljore *marr vesh* = mësoj (Cf. rus. *узнать*; fr. *apprendre*; mësoj një të re, një lajm).

*Këtu* / në Napoli, S.F. / u muar vesh se në vënt që ta ndihmonte Ferdinandi Skënderbenë kundër Turqve, tani duhej që Skënderbeu ta përkrahte Ferdinandin kundër Frëngëve dhe Baronëve. / Noli: HeS<sup>2</sup> (88) /

*Nga kjo merret vesh* faqeza, ( ) se drita, sa të vinjë nga nj'an' e rrethit e m'anët tjetrë, bëka 16 të holla 26 grima. / Naim Frashëri: Di-turi... (113) /

U muarr vesh pas *dëftimesë* që dega është m'e shkurtërë nga shu-fra... / Idem, Ibidem (196) /

*Nga kto lajme merret vesh* që Skënderbeu këtë mot ishte bërë oficer i lartë i ushtërisë turke dhe dërgohej prej Sulltanit si kumandar i përgji-thëshëm në shpedita të ndryshme / Noli: HeS<sup>1</sup>, I /

*Nga kjo merret vesh* që (Gjon Kastrioti, S.F.) ishte shqiptar i ku-luar... / Noli: HeS<sup>2</sup> (18) /

Trajta foljore *dihet* paraqitet me po ato karakteristika gramatikore si dhe trajtat *thuhet*, *kuptohet*, *merret vesh* kur janë të pashoqëruara prej gjymtyrësh të dyta që tregojnë burimin e dijes. Folja *dij* (*dihet*) nga kuptimi leksikor tregon rezultatin e një perceptimit shqisor ose mendor.

*Dihet që* nuk bëhet më njeri ai. / K. Cipo, Sintaksa (86) /

*Dihet se* vëndi ynë ka qënë më i prapambeturi në Evropë nga ana industriale. / Hoxha: 10-vjetori i çlirimit (17) /

*Dihet se* tek ne lloji kryesor i transportit është transporti automo-bilistik. / M. Shehu: Kg.III, (18)

Folja *kujtohet*, që tregon të perceptuar rishtazi pavarësisht ose kundra vullnetit të subjektit të një ngjarjeje të kaluar, ka si pjesë të pandarë të konstruktit një emër a një përemër vetor në rasën dhanore, që tregon personin-subjekt llogjik të perceptimit. Pa këtë gjymtyrë folja *kujtohet* mund të merret si vetore e vetës së tretë (ai kujtohet) dhe nuk përbën kallzues të një fjalie pa kryefjalë e si rrjedhim fjalia e varur nuk mund të jetë kryefjalore.

Folja kallzues e fjalisë kryesore përdoret rëndom në kohë të tashme, në të pakryerën dhe në të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore.

Po kur më kujtohet

që / shokët, S.F. / janë të vdekur,

në dhet janë tretur,

zëmra më tmerrohet. / Naim Frashëri: LEV, të vdekuritë /

*I kujtohet Xhavidit* se tamam aty ku ka qëndruar, pat plasur një predhë mortaje. / Dushi: UeV, IX, 4 /

Gjithënjë buzëqeshte Nushi dhe herë herë *I kujtohej* se para një ore mundëte me të vërtetë të bajë një gjest donkishotesk.

/ Migjeni: Vepra (171) /

Po menjëherë m'u kujtua se të djeshmen, përmbi fshat, kaloi lufta. / S. Andoni: Maleve... (79) /

E plaku këtë hyzmet do t'ua bënte / pemëve, S.F. /

Duke ecur (,), iu kujtua se kryetari i kishte premtuar një kalë për të vajtur në qytet. / Gjata: Tana 2 (70) /

[— Harri Fullci gjeti njerën pas tjetrës tri dosje...]

Iu kujtua se një mbrëmje, duke parë dy dosjet e para (,) kishte thënë... / Gjata: Këneta (447)

1.1.1.4. Foljet që tregojnë proces të të menduarit (më saktë vlerësim subjektiv të një ngjarjeje a fakti) përfaqësohen në shqipen e sotme nga dy folje: *zë*, *besoj* që mund të kenë trajtën korelative *zihet* (*zehet*), *besohet* si kallzues të fjalisë kryesore. Korelacioni kryefjalë-kallzues dhe kryefjalë-kallzues-objekt paraqitet në mënyrë të ndryshme në këto dy folje. Ndërsa te folja *zë* kemi për trajtën veprorë korelacionet: Kr+Kllz+O+A. (ku *kr.* është kryefjala, *kllz.* = kallzues, *O* = objekt, kundrinë, *A* = atribut, plotës kallzuesor: *E zumë lojën të fituar* dhe folja *zë* ka kuptimin *konsideroj*, *supozoj*, *pandeh*, *quaj*, trajta *zihet* e foljes mund të përdoret si vetore-njëvetore: (kr. + kallz + A): *loja u zu e fituar*, me të njëjtin kuptim të mësipërmë, në periudhë mund të ndodhin vetëm dy variantet: folja *zehet* mund të përdoret ose 1) si këpujë, e cila kërkon lidhjen me fjali të varur kryefjalore dhe një fjali të varur kallzuesore njëkohësisht, dhe në këtë rast funksionon si vetore-njëvetore, ose 2) si folje njëvetore-pavetore, ku logjikisht mbisundon kuptimi pavetor.

Le të shohim shëmbujt:

Me e tundue kush rrogtarin e kishës me fjalë a me punë, xehet se tundon famullitarin, e bjen në giobë të kishës mbas Kanunit.

/ Gjeçov: KiLD (4/11) /

Në këtë shëmbull konstrukti «me tundue kush rrogtarin e kishës me fjalë a me punë» shërben si kryefjalë e kallzuesit *xehet* ndërsa konstrukti me lidhëzën «se tundon famullitarin» funksionon si plotësor kallzuesor, si fjali e varur kallzuesore. Karakteristike për kësaj periudhash është fakti se kur folja *zihet* (*zehet*, *xehet*) paraqitet me kuptimin e një vlerësimi supozitiv ajo duhet të ketë *domosdo* një konstrukt që të shërbejë si kryefjalë dhe një konstrukt tjetër që të shërbejë si kallzuesor, si plotës kallzuesor i kryefjalës. Në këtë rast folja *zihet*, duke ruajtur përbrenda periudhës po atë korelacion kryefjalë-kallzues që ka dhe në fjali paraqitet vetore-njëvetore jo vetëm gramatikisht po edhe nga pikëpamja e brendisë logjike. Ndryshe ndodh puna në shëmbullin e mëposhtme të po ati autori.

Kanu asht pra, qi t'i prihet mikut, sepse xehet se nuk din a do të ndeshet në mik a n'anmik. / Gjeçov: KiLD (67/642) / Në këtë periudhë kallzuesi *xehet* i fjalisë së varur shkakore (që është fjali kryesore për fjalinë e varur të shkallës tjetër) paraqitet si folje pavetore nga pikëpamja e brendisë logjike lidhur me ndonjë subjekt-kryefjalë: ç'thuhet në periudhë para tij nuk mund të bëhet kursesi objekt i vlerësimit të kallzuesit *xehet*, ky paraqitet si pavetor dhe për këtë arsye fjalie e varur, «se nuk din rrugë» nuk shërben si kryefjalë e këtij kallzuesi, pra edhe e fjalisë ku ndodhet ai. Ky funksion përforcohet më shumë nga fakti se pranë foljes *xehet* nuk mund të përdoret, pa e bërë konstruktin artificial, ndonjë emër e përemër në rasën dhanore që të tregojë personin që «pëson» gjendjen e vlerësimit psikik të shprehur nga folja. Nuk thuhet pra: *Zihet nga ne a prej nesh se...*

§ Tek folja *besohet* mund të kemi vetëm njërin kuptim të foljes *besoj* dhe pikërisht atë *kujtoj*, *pandeh*, *konsideroj* dhe jo kuptimin *kam besë*, *kam besim*. Ky kuptim i dytë është ekskluziv për konstruktet veprorë.

Folja *besohet* si kallzues i fjalisë kryesore mund të paraqitet si vetore ose si krejt njëvetore, si në dy shëmbujt e mëposhtme, respektivisht:

Ndonëse / Skënderbeu, S.F. / e kishte shkuar tërë jetën në beteja dhe kishte vrrarë me qindra armiq me dorën e vetë (,) nuk ishte plagosur veçse një herë të vetëm në shpatull, edhe besohej që ishte i mprojtur prej një fuqia magjike. / Noli: HeS<sup>2</sup> (114)

Prania e së njëjtës kryefjalë të tri fjalitë priese «Skënderbeu» dhe e foljes kallzues *besohej* mund të bëjë që ta marrim këtë folje si vetore: *Skënderbeu... besohej që ishte i mprojtur...*, por folja *besohej* mund të mirret edhe si njëvetore dhe në këtë rast konstrukti «*që ishte i mbajtur prej një fuqie magjike*» do të merret si fjali e varur kryefjalë ndaj një fjalie ku kallzuesi është njëvetor.

Në shëmbullin e mëposhtme karakteri njëvetor i foljes duket më qartë:

/ Ili dhe Afërdita / Ndejtën të dy në një gur për anë të rrugës.

— As që *na* besohej në fshat se mund të të shihnim prapë

Këtu, si dhe në shëmbujt e theksuar më sipër, § I.1.1., plotësisht i vendit në fshat nuk ka për funksion të tregojë vendin se ku *u* *besohej* apo jo, por ka për funksion të tregojë tërthorazi atë rreth një-rëzish që banojnë në fshat dhe të cilët janë bartës të gjendjes së të besuarit. Folja *besohet* paraqitet krejt njëvetore dhe vetëm nëpërmjet të të qekuri në fshat mund të tregohet nga pikëpamja logjike atë rreth një-rëzish që kanë të bëjnë me procesin e të besuarit. Nga pikëpamja logjike e vetës në periudhë kemi vetë të caktuar (*na ... në fshat*) pra *ne*, *banorët e fshatit tonë*.

Në skaj të foljeve që tregojnë një gjendje të brendëshme a proces psikik qëndron folja *shpresoj*. Trajta veprorë e kësaj foljeje ka si karakteristikë drejtimin e saj të zhdrejtë, prandaj ajo paraqitet si kalimtarë e zhdrejtë: nuk thuhet: *shpresoj një shpërblim*; *shpresoj shërim të shpejtë*, dhe ndonëse e mundëshme, por për sistemin e shqipes së sotme mjaft artificiale do të dukej togfjalëshi: *shpresoj në një shpërblim*, *shpresoj në shërimin e shpejtë*: prap se prap karakteri kalimtar vepror i foljes zbulohet tërësisht në pyetjen: *Ç'shpreson? Çfarë shpreson?* ku fjalët pyetëse *ç*, *çfarë* paraqiten qartë me funksionin e tyre objektor të drejtë; ky karakter kalimtar zbulohet gjithashtu në periudhë: *shpresoj të shpërblehem*, *shpresoj të shërohem* (ose *se do të shpërblehem*, *se do të shërohem*).(\*)

Trajta foljore *shpresohet*, me sa dijmë ne, nuk përdoret në shqipen popullore. Përdorimi i saj është në këtë sfond një përdorim i ri, i dalë nënë influencën e gjuhëve të huaja (sidomos e frëngjishtes etj.). Një herë, megjithatë, u shpresua se kanali do të çilej. / Shuteriqi: Çlirimtarët /.

I.1.1.5. Nga grupi i foljeve që tregojnë vullnet, si kallzues i fjalisë kryesore në shqipen e sotme përdoren një numur shumë i kufizuar. Nga pikëpamja e korelacionit vepror-pësor do të kishim këto: *dua-duhet*; *kërkoj- kërkohet*; *lyp-lypet* (lipset); *le-lehet*, *lejoj-lejohet*; *ndaloj-ndalohet*; *vendos-vendohet*; *përfundoj-përfundohet*; edhe ndonjë folje tjetër me përdorim jopopullor.

Në lidhje me trajtën *duhet* është e nevojëshme të themi sa vijon:

Ndonëse ajo ka dalë nga korelacioni kalimtar vepror-pësor, për të cilën ndihet akoma ndonjë gjurmë e vogël në sistemin kryefjalë-kallzues përbrenda fjalisë, prap se prap në gjuhën e sotme shqipe trajta *duhet* ka humbur shumë si nga pikëpamja leksikore ashtu edhe nga pikëpamja

(\*) Më gjërë këtë çështje e kemi trajtuar në një punim të pabotuar akoma, me titull «Periudha me fjali të varur kundrinore në shqipen e sotme».

gramatikore; duke kaluar nëpërmjet të përdorimit njëvetor-pavetor ajo ka arritur të gramatikalizohen pothuajse plotësisht; ajo është shndruar pothua në një folje modale pak a shumë të ngurosur, në një farë pjesëze modale të domosdoshmërisë: e ngurosur për mënyrën, për vetën dhe për kohën. Ndonjë korelacion «e tashme e shkuar» *duhet-duhej* që mund të përdoret akoma, s'ngre kandar, mbasi ato raste sa vinë e rrallohen dhe duket qartë tendenca e pashmangëshme për kthimin e trajtës *duhet* në një pjesëze modale pranëfoljore.

Ndërsa në shëmbujt e mëposhtëm:

«*Duhet të plotësojmë e të tejkalojmë planin*»

«*Lipset të kujdesemi për shëndetin tonë*», / Cipo: Sintaksa /.

fort fort mund të vendosnim një farë korelacioni të pjesëve të nënëvizuara të shëmbujve nga njëra anë, dhe të një kryefjale të shprehur me emër ose gjymtyrë të substantivuar: *Duhet plotësimi dhe tejkalimi i planit*» «*Lipset kujdesi për shëndetin tonë*», prapë duhet të vërrenim se këto konstrukte «nuk mbajnë fort erë shqipe» siç thoshte Prof. Cipo; në shëmbujt e mëposhtme del krejt i qartë se ky korelacion kryefjalë-kallëzues nuk mund të vendoset më:

Buka e gjella tretetë përpara në gojë, duke përtypurë me dhëmbë, e duke përzjerë me përshtymëtë, andej *njeriu duhet të përtypnjë* mir'e ngadalë në gojë ngrënjenë / Naim Frashëri: Dituri... (79) /

*Njariu duhet të mos rrijë i urëtë*, po të hajë sa të ngingjetë nukë sa të fryhetë. / Idem; ibidem (79) /

Po t'ishte fjala *duhet* folje kallzues, si kryefjalë e saj s'mund të ishin njëkohësisht emri *njeriu* dhe trajta e lidhore me gjithë gjymtyrët e varura prej saj; që këtu shihet se trajta *duhet* është bashkuar në një gjymtyrë fjalie me foljen në lidhore kurse si kryefjalë e gjithë këtij konstrukti të marrë të pandarë shërben fjala *njeriu*. Edhe më qartë akoma del karakteri i ngurosur i fjalës *lipset, duhet*:

*Gjithë njerëzitë, të vegjël'e të mbëdhenj, lipsetë të punojnë e të mos jenë përtësës.* / Naim Frashëri; E këndimit... (1) /

— Ja se ku zjen kazani i urrejtjes, i kryengritjes, kish thënë Enveri. — Me të, *ne duhet t'i përvëlojmë* të gjallë fashistët italianë e shqiptarë... / Shuteriqi: Çlir. (I) (200) /

Mospajtimi i trajtës *duhet, lipset* me një kryefjalë në shumës tregon se këto trajta përbëjnë së bashku me foljen në lidhore një kallzues të pandarë tek i cili fjala *duhet* shtie kuptimin e modalitetit. Fjalët *duhet, lipset* mund të shërbejnë si kallzues ndaj një fjalie tjetër vetëm në raste fort të rralla, kur kanë kuptim nevoje. Pavarësisht nga ndonjë fenomen historik i tërheqjes ose i spostimit të gjymtyrëve, në gjuhën e sotme shihet tendenca e shndrimin të tyre (sidomos e *duhet*) në folje modale të një kallëzuesi të përbërë modal.

Folja modale e ngurosur (pjesëze modale pranëfoljore) *duhet* mund të shërbejë për të krijuar kallzues njëvetor së bashku me trajta foljore jovetore siç është pjesorja. Këtu mund të kemi dy raste: ose folja në trajtën njëvetore mund të përdoret (është fakt i tanishëm i gjuhës shqipe) dhe në këtë rast fjala *duhet* përforcon karakterin modal të fjalisë, karakter të shprehur nëpërmjet të trajtës së lidhore; ose fjala *duhet* shërben për të krijuar së bashku me foljen në lidhore një kallzues njëvetor me nuancën e domosdoshmërisë, ku folja vetë nuk përdoret në trajtën njëvetore-pavetore me karakterin modal të mënyrës dëftore: fakt a ngjarje reale.

a) folja *them, thom* ka trajtën *thuhet* (dialektore *thohet* në mënyrën dëftore me modalitetin e dëftores, dhe veç kësaj nëpërmjet të bashkimit të fjalës *duhet* dhe të pjesores *thënë* formohet kallzuesi *duhet thënë* të cilit fjala *duhet* i ep nuancën modale të domosdoshmërisë.

Por *duhet thënë* se në mjaft zona uji nuk po çfrytëzohet siç duhet dhe vaditja nuk po e ep atë rezultat që duhet të api. / E. Hoxha: Kg. III. F.D. /.

*Duhetë thënë* se në kohët e fundit Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve ka marrë masa të mira për majmërinë e bagëtisë, por kjo është vetëm fillimi. / E. Hoxha: Mbi masat... (33). /

b) folja *përmënd* jo vetëm në të folurit popullor, por edhe në gjuhën e shkruar të stilit publicistiko-shkencor rrallë ka trajtën *përmëndet* që të funksionojë si kallzues njëvetor ndaj të cilit të përdoret një fjali e varur kryefjalore; në gjuhën e shkruar, kryesisht të stilit publicistiko-shkencor gjejmë shëmbuj të përdorimit të kallzuesit njëvetor-pavetor *duhet përmëndur*.

*Duhet përmëndur* se në vjetët e parë të pesëvjeçarit të parë transporti nuk përballonte dot nevojat e ekonomisë popullore. / M. Shehu Kg. III (18) /.

*Duhet përmëndur* që plani pesëvjeçar u realizua vetëm në shtimin e numurit të qeve të punës, kurse nuk u realizua në shtimin e numurit të lopëve, dhenve e derrave. / M. Shehu: Kg III /.

Një gjë e ngjajshme ndodh edhe me foljen *harroj*, por me ndonjë ndryshim.

Ndërsa nuk kemi në përdorim trajtën foljore *harrohet* të mënyrës dëftore (pa ndonjë gjymtyrë tjetër kundrinore: *më, të i, etj.*) kemi në përdorim kallzues njëvetorë me nuancën e domosdoshmërisë të shoqëruar me pjesëzën mohuese *s*, dhe veç kësaj modaliteti është shprehur dymënyrash: në gjuhën e shkrimit sidomos me fjalën modale *duhet* (pra *s'duhet*) kurse në gjuhën popullore nëpërmjet të pjesëzës *do* me kuptim të njëjtë modal. *Duhet* theksuar se pjesëza mohuese *s* ose *nuk* është pjesë përbërëse e konstruktit.

Dhe këtu *s'duhet harruar* se Gjon Muzaka ishte lule përpara të tjerëve, se ky të paktën qëndroj nga ana e Skënderbeut gjer në funt, edhe pas vdekjes së tij. / Noli: HeS<sup>1</sup> (Hyrje, III) /.

*Nuk duhet harruar* se suksesi i luftës nëpër qytete varet tepër nga inicjativa lokale e komandantëve, nga ngritja e barikadave të ofensivë dhe partizanëve. / M. Shehu: Në pragun e çlirimit (IV) /

*Nuk do harruar* se nyja e përparme ka qënë në krye të herës një element përemëror. / Cipo: Sintaksa (84) /.

*Nuk do harruar* se ka edhe plotës lënde me ndjafolje

/ Idem, ibidem (70) /

II.1.1.5.1. Mjaft i kufizuar është numri i foljeve që tregojnë shprehje të vullnetit dhe që kanë trajta njëvetore korelative me kallzuesit përkatës në fjali të pavarur. Krahaso përdorimin vetor të foljeve të shembujt: *lejohet gjuetia, ndalohet duhani, kërkohet kafsha* që ka humbur, *lypet beja, u përfundua marrëveshja, u vendos sulmi*, etj. me po këta kallzues në periudhat e mëposhtme:

Kërkohet, pra, që të ngrihet përgjithësisht niveli kultural i punëtorit a i fshatarit, përndryshe do të vështirësohet puna jonë në ndërtimin e socializmit. / E. Hoxha: Kg III F.D. /

Bën nëgojësh kanûja as s'e pëlqen, as s'e tumirë; e për të dliun prej zhgarkimesh lypet doemos qi të bahet beja mbë një shêj besimi e të përkitet me dorë. / Gjeçov: KiLD (60/531) /

[Kuvëndi u mbajt në kishën e Shën Kollit në Lesh, më 1 të Marsit 1444] u përfundua të formohet një Ligë e Kapedanëve Shqiptarë, dhe Skënderbeu u zgjodh me një zë kryetar i saj dhe kryekumandar i ushtrisë federale. / Noli: HeS<sup>2</sup> (32) /

Kur përdoret / fjala tërë S.F. / si përemër, lejohet të marrë një të përparme. / Cipo: Sintaksa (35) /

Në këta shëmbuj, fjalia kryesore nuk përmban ndonjë gjymtyrë që të tregojë personin të cilit i drejtohet shprehja e vullnetit; kur duhet përmendur një person i tillë, emëri a përemëri vector që e tregon vihet në rasën dhanore.

I rekomandohet *Këshillit* të Ministrave që, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 1959, t'u kalojë kooperativave shtetërore të grumbullimit kullotat dhe fushat në përdorim të përherëshëm. / E. Hoxha: Mbi masat... (151)

... A të lejohet ty si komunist të vepros në këtë mënyrë? / Gjata: Kënetë (398) /

Të *parit* i lehet të shofë ben (,) e të dytit (—) të bajë ben. / Gjeçov: KiLD (61/543) /

... Na është ndaluar të quajmë një sharrë të vogël «sharrëzë», sepse me këtë emër quajmë një farë sëmundje të fytit. / Cipo: Sintaksa (21)

Ne na kërkohet tani që në këto kondita të reja të gjejmë mjetet dhe format e punës që i tërheqin masat e gjëra të qytetit dhe fshatit në realizimin e këtyre detyrave të mëdha që na dalin përpara. /

*Atyre* duhet t'u rekomandohet që të krijohet skuadra e ndërtimit në çdo kooperativë bujqësore për prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe për ndërtimin. /

Shumica e rasteve të përdorimit të foljeve të mësipërme me funksionin e një kallzuesi njëvector i takojnë gjuhës së shkruar, sidomos shkrimeve të stilit publicistiko-shkencor, dhe këtu mund të jetë shprehur edhe një farë influencë nga gjuhët e tjera të mëdha si rusishtja, frëngjishtja etj. Gjuha e shkruar ka nevojë për kësi konstruktësh që të mundë të tregojë nuanca të ndryshme të karakterit pavector të kërkesës, që të tregojë me saktësi një brendi më të ndërlikuar, e cila zakonisht nuk ka bazë egzistence në gjuhën e folur të përditëshme me karakter popullor.

#### 1.1.1.6. KALLËZUESI I FJALISË KRYESORE ËSHTË FOLJE KALIMTARE VEPRORE

Rëndom foljet kalimtare vepërore nuk shërbejnë si kallzues të fjalisë kryesore të periudhat me fjali të varur kryefjalore, por tek ato me fjali të varur kundrinore, që kryejnë një funksion sintaksor adekuat me atë të një gjymtyrë kundrinore (të drejtë ose të zhdrejtë, me parafjalë a pa parafjalë). Por disa folej kalimtare vepërore, që bëjnë pjesë në togfjalëshe të caktuar ( $F + E = \text{folje} + \text{emër në rasën kallëzore pa parafjalë}$ , si kundrinë e drejtë e kallzuesit) mund ta kryejnë atë funksion. Prania e foljes në togfjalësh me kundrinë të drejtë ep mundësi që në rast se fjalisë kryesore i mungon kryefjala, fjalia kryefjalore të vihet në korelacion me po atë folje në vetë të tretë njëjës dhe të kryejë funksionin adekuat.

Kësi foljesh ka pak: grupin më të madh e bën folja kalimtare *kam*, te togfjalëshet (*s'*) *ka kuptim*, (*s'*) *ka rëndësi*, (*s'*) *ka lezet*, (*s'*) *ka hije*. Këto shprehje mund të hyjnë në korelacion me emëra abstraktë (ose edhe me emra konkretë) në rolin e kryefjalëve: p.sh. *kjo fjalë, ky veprim (s')ka kuptim; çështja (s')ka rëndësi; një jetë e tillë burrit s'i kishte aspak hije!...* / A. Abdihoxha: Një vjeshtë me stuhi (100) /. *Kjo gjë ka lezet.*

Megjithëse mund të bëhet një farë spostimi i vogël i kuptimi leksikor, besoj se ai nuk është aq i rëndësishëm sa të prishë korelacionin kryefjalë-kallëzues (përkitazi fjali e varur — fjali kryesore).

Se *nuk kishte kuptim*, sa herë që beu i vogël nisej për Tiranë, ajo (do) t'i ngjiste prapa edhe Qazimin. / Abdihoxha: Vjeshtë me stuhi (133) /.

— Mos folë kështunë, se *nuk i ka hije një urate* të thotë për gjuhën tonë që është e mallëkuar! / M. Grameno: Varri i Pagëzimit (25) /

Vasili (Lenës) *Nuk ka hije të sillesh kështu me një plak: pak respekt për flokët e tij të bardha.* / Paçrami: Mbi gërmadha (Akti I, t. I), in «Dy drama» (68) /.

Otua — *Ka rëndësi të madhe që heroizmin tënd ta shohin eprorët e tu.* / Q. Buxheli: Dueli, I, 5 («Nëndori», Nr. 12, 1963 (39) /.

Kur binte zilja e parë, *zotit Vasil i kishte lezet* të delte në majë të shkallëve e të shikonte nxënësit që viheshin në resht.

/ Abdihoxha: Vjeshtë me stuhi (52-53) /

Ka edhe ndonjë shprehje tjetër me shtyllë folje kalimtare vepërore si (*s'*) *prish punë*, (*më*) *bën përshtypje*, (*më*) *heq vërejtjen*, etj. Foljet e këtyre shprehjeve mund të marrin në vetën e tretë një kallëzues emër, prandaj edhe një fjali të varur kryefjalore.

— Merre një pozë në gjumë, — e porositi kinoregjizori kolegun e tij. — *S'prish punë* që e ka kokën nga duhet të kish këmbët / Buxheli: Një ndodhi në plazh (122) /.

(...) fillova (...) të shkoja natë për natë në kino. *S'prishte punë* që aty çfaqej vetëm «Kashej i pavdekshëm». / Idem, ibid. 118

*Më bëri përshtypje*, ( ) se gjatë kohës që ishim bashkë, shoqëronjësi nuk kishte shqiptar asnjë fjalë. / Idem, Ibidem (59) /.

Emira i hodhi sytë padashur / ilustraxhiut, S.F. / dhe *i hoqi vërejtjen* që ai e përshëndeti si njeri të njohur / Musaraj: Para agimit /.

### 1.1.1.7. KALLËZUESI FOLJOR ËSHTË NJË FOLJE PAKALIMTARE

Vetëm një pjesë e vogël e foljeve pakalimtare përdoret si kallëzues i fjalisë kryesore së cilës i mungon kryefjala. Funkcionalisht punën e kryefjalës mungesore e bën fjalia e varur në rast se trajta vetore e vetës së tretë (njëjës) mund të marrë në kushte të caktuara ndonjë kryefjalë: ndër to, grupi i foljeve që tregojnë të *ndodhur* e pranon më qartë këtë bashkëlidhje, këtë opozicion: më qartë foljet *ngjan*, *ndodh* por më pak qartë foljet *qëllon* dhe *rastis*; kjo e fundit mund të lejojë marjen e një kryefjale në goftë se merr kuptimin «ndodhi, u gjend rastësisht», por duke qënë se nuk përdoret pranë emërash që tregojnë vepërim, opozicioni mbetet i dobët p.sh. *aty rastisi bariu i fshatit*, dmth. «aty u ndodh, u gjend rastësisht bariu i fshatit». Por pamundësia për të thënë p.sh. «*pardje rastisi një furtunë e madhe*» i ep një karakter mjaft artificial opozicionit njëvetor dhe vetor.

**I.1.1.7.1.** Fjalìa e varur mund të shërbejë si kryefjalë e një foljeje jokalmittare që tregon në përgjithësi të *ndodhur*, të *ngjarë*. Këto janë foljet e mëposhtëme: *godit*, *ndodh*, *ngjan* (*gjan*), *ngjet*, *qëllon*, *rastis* (në kohë dhe mënyra të ndryshme). Këto folje në fjali të pavarur paraqiten njëvetore (ndodhi e keqja; ngjau e papritura; ose jokalmittare vetore me një kryefjalë që tregon person: aty *qëlloi një bari*; n'atë kohë *rastisën atje dy burra*; ka disa folje që paraqiten kurdoherë pavetore: *goditi* që isha pa cigare). Sidoqoftë fjalìa e varur kryen funksionin e kryefjalës sepse mund të vihet në korelacion me një kryefjalë në fjali të pavarur, ose sepse vihet në korelacion me ndonjë nuancë tjetër të asaj foljeje.

Si kallzues i fjalisë kryesore përdoren më shpesh foljet *ndodh*, *ngjan* dhe *qëllon* (gg. *qillon*). Foljet e tjera janë më pak të përdorura: *godit*, *rastis*.

Folja *ndodh* mund të tregojë një ngjarje të zakonëshme, por në disa raste edhe ngjarje të rastëshme.

/ Dhe kur e marrin misrin, / malsorët / nisen njani mbas tjetrit... /  
Ndodhë (= *ndodh*) që njenit i derdhen kokrrat e misrit nëpër birë të vogël të thesit... / Migjeni: Vepra: Legjenda e misrit /

/ Me vra e shoqja të sho' in, prindja e kësaj biejn në gjak /. Ka ndollë (= ka ndodhë) qi prindja e ka gri të bin, qi bâte ket shemtim. / Gjeçov: KiLD (90/904) /

*Ndodh* nganjëherë që plotësi i mjetit të mos jetë në shesht, po në thest, d.m.th. të jetë futur i fshehur brënda në foljet.

/ Cipo: Sintaksa (74) /

/ — ... Sa më është dhimsur ai zagar. (!) ... /

— Po si *ndodhi* xhanëm që e humbe? — pyeti gjykatësi / Kallamata: Nete gjahtarësh (75) /

Folja *ngjan* përdoret më shumë ndër të folme e shkrime të dialekteve të jugut.

Kështu *ngjau* që fillova të hyj përsëri në udhën e njerëzve. / Musaraj: Isha unë... (31) /

*Ngjau* një ditë pas ca vjetësh q'e gjeta Kolën e ndënjur mbi një gur të vjetër me kokën ndër duar. / Andoni: Maleve... (72) /

Foljet *qëllon*, *godit*, *rastis* dhe (më) *ka takuar* tregojnë më tepër se ngjarje ka qënë diçka e rastit.

Po u qortue grueja, mbas së lutmes së dashamirve, *qillon* qi burri e mërr persri. / Gjeçov: KiLD (20/31) /

Goditi që keshe mik këta të Korçës. / S. Floqi: Skicë... /

Edhe folja *takon* në kohët e shkuara dhe e shoqëruar nga përemëri vetor në dhanore mund të paraqitet me kuptimin e foljes *qëllon*, *godit* *rastësisht*.

*Ju ka takuar* ndonjëherë të dalldisni nga zemërimi?

/ Musaraj. Isha unë... (29) /

Në përbërjen e fjalisë kryesore mund të ketë edhe ndajfolje kohe si *nganjëherë*, *ndonjëherë*, *shumë herë* ose *shpesh*, të cilat e theksojnë edhe më shumë karakterin e parregulltë të ndodhjes.

*Ndodh* nganjëherë që të zëmërohen edhe t'urtit. / Cipo: Sintaksa (66) /

*Ju ka takuar* ndonjëherë të dalldisni nga zemërimi?

Kur *qëllonte* nganjëherë që këmba i zhytej deri në gju, ai

/ Llambi Linua / nxirte një psherëtimë e murmuronte një të sharë... /

/ Dushi: UeV, XI, 2 (241) /

/ Tefta dhe Coli / Mësonin shpesh të dy, ndihmonin shoqi-shoqin në mësimet dhe nuk linin t'ua kalojë njeri /. *Ngandonjëherë*, qëllonte që njëri t'ia kapërxejë tjetrit, po shoq përmbi vete s'kishin pasë kurr(ë). / Shuteriqi: Çlir. (I) (28) /.

*Shpesh*, qëllon që gurët e mullirit të nxirren larg vendit ku do të punojnë, sepse guri i përshtatshëm nuk gjindet kudo.

/ Shuteriqi: Çlir. (II) (II/).

I.1.1.7.2. Folja jokalmtare (më) *pëlqen* e cila në fjali mund të përdoret si vetore (më pëlqejnë portokajtë, më pëlqen buka e misërt), në periudhë përdoret si njëvetore, dhe në periudhë fjalia e varur shërben si kryefjalë vetë në sajë të korelacionit me përdorimin njëvetor në fjali të pavarura. Ashtu si dhe në fjali. edhe në periudhë personi që pëson predileksionin ndaj sendit e ngjarjes vihet në rasën dhanore.

— ... Ai / Pirroja / është i ngutur, nuk arësyeton si duhet dhe... *nuk i pëlqen* të përfitojë nga pervoja e shokëve...

/ Spasse: Afërdita... (145) /

Shumë *rretheve imperialiste*, natyrisht, *nuk u pëlqente* që gjendja të rrokullisej në disfavorin e tyre... / Hoxha: Kg.III

— ... Lirinë mund ta kishit fituar dhe me trimërinë tuaj edhe me një tiatër çlirimtar, se Shqipërisë nuk i mungojnë burrat, po *ju pëlqeu* ta prisni nga doma ime... / Noli: HeS<sup>2</sup> (29) /

— Djali e ktheu gjysmën e gastallit / me raki, S.F. / që i kish mbetë pa pirë..

— *Më pëlqen* ta shijoj, tha... / Shuteriqi: Çlir. (I) (155) /

*Filja: Sa më pëlqen* të dëgjoj rëfimet tueja.

/ K. Jakova: Toka jonë<sup>1</sup>, III,

I.1.1.7.3. Personin në rasën dhanore kërkojnë edhe foljet jokalmtare (më) *takon*, (më) *përket*, (më) *intereson*, (më) *mbetet* (s'më *mbetet*).

Folja *më takon* tregon në këtë rast se brendia e fjalisë së varur është diçka që lidhet me personin nga pikëpamja e së drejtës së tij të pamohueshme, ose nga pikëpamja e detyrës, detyrimisë) së tij për kryerjen e veprimt. Gjithashtu edhe folja (më) *përket*.

Folja (më) *mbetet* si kallzues i fjalisë kryesore kërkon që fjalia e varur të bashkohet drejtpërdrejt me trajtat e lidhores, por në rast se kallzuesi është mohor, atëherë edhe me lidhëzën *veçse* (më rrallë *përveçse*) P.sh.: Nuk na mbeti *veçse* të prisnim.

*Klasës punëtore* të vëndit tonë i takonte tanimë të organizonte revolucionin e vërtetë antiimperialist dhe antifeydal, revolucionin demokratik popullor të të gjithë patriotëve të Shqipërisë dhe në krye të tyre ta çonte atë në fitoren e plotë. / Hoxha: Kg III F.D. (7) /

— Ju jini e zonja për këto punë... Po *ne(ve) na intereson* që atij / Stavrit, S.F. / t'ia mbyllim sytë. / Gjata: Këneta (256) /

I.1.1.7.4. Në periudhë si kallzues i fjalisë kryesore mund të përdoren folje të representacionit, të paraqitjes si folja *duket*, *ngjan*. Këto folje në fjali të pavarur janë të gjitha vetore, kurse në periudhë janë njëvetore. Ato tregojnë se subjekti pëson një dukuri, një përshtypje (rëndom — të rremë) nga fenomeni që përmëndet në fjalinë e varur (krahaso: nxënësi du-

ket i zgjuar; *gjan i urtë i marri* sa pa hapur gojën; etj. Natyrisht në periudhë këto folje paraqiten me një kuptim të spostuar, me kuptimin e përgjithshëm të të ndikuarit me një përshtypje subjektive nga ana e fenomenit që shtjellohet në fjalinë e varur. Ndër këto folje folja *duket* është e mbarë shqipes, si e gjuhës së shkruar ashtu edhe të gjuhës së folur. E mbarë shqipes është dhe folja (*më*) *bëhet* (gg. m'bâhet, m'bôhet, etj.), por vetëm e shqipes popullore, dhe përdoret sidomos tek ata shkrimtarë që riprodhojnë mjaft afër gjuhën e folur popullore. Foljet e tjera janë pak a shumë dialektore. Kuptimi i këtyre foljeve në periudhë mund të paraqitet i tejsenantizuar dhe fjalia e varur të jetë me zor kryefjalore.

Trajtat më të përdorëshme të këtyre foljeve janë ato të së tashmes, të së pakryerës dhe të së kryerës së thjeshtë.

Kryetari s'kish të drejtë (,) dhe *duket* se ai nxehej me Tanën për punë tjetër. / Kështu mendonte vajza / Tana / Gjata: Tana /  
/ Prej portës së karabinerisë dual dy vetë, që ecnin kraj për krah... / *Dukej* se bisedonin, sepse kohë më kohë, ndaleshin e qëndronin përballë shoqi-shoqit. / Shuteriqi: Çlir. (II) 301) /

*Duket* që nuk i pëlqen ato fjalë. / Cipo: Sintaksa (86) /

Gjer në fund të korrikut, humbjet turke kishin arrirë 20.000, dhe *u duk* që Sfetigradi nukë merrej dot me forcë. / Noli: HeS<sup>2</sup> (56) /

Personi që pëson (percepton) përshtypjen, të dukurit vihet në rasën dhanore edhe kur është emër, edhe kur është përemër vetor, por kjo gjymtyrë nuk është e domosdoshme për kuptimin e foljes.

/ — Qënka, zor grama, dreqi e mori!

— Po ç'kujtove ti, bukë me qiçra? /

— *Më duket* se jemi ne të trashë nga mëndja, pa grala s'është gjë! / Gjata: Këneta (154) /

/ — ... Dëgjomë mua. Dëgjon? /

— Dëgjoj e *më duket* se ke të drejtë. / Idem, Përmbysja, II, 4

/ Doktorin e ndiqte luftën si një i çakërdisur /. *I dukej* se po asistonte në një lojë të tmerrshme. / Shuteriqi: Çlir. (II) (VI, 5)

/ Luftari, duke vënë veshin, dëgjoi angullimën e një ujku diku fellë, e kur egërsira pushoi (,) *iu duk* sikur dikush ecte në pyll, me hapa të lehta, si dhelpër. / Gjata: Përmbysja, III, 1 /

*Mua më duket* se e dua Velanin njësoj si këta... /

/ Dushi: UeV (VII, 1) /

Ndërsa në foljen *duket* përdorimi i emrit të personit ase përemërit vetor ishte fakultativ, tek foljet e tjera emri e përemëri vetor në rasën dhanore është pjesë përbërëse e konstruktit pavetor (dhe folja ka kuptimin që po trajtojmë vetëm në këtë rast, përndryshe ka kuptim mjaft të ndryshëm), prandaj në strukturën e fjalisë kryesore do të kemi domosdo emërin e përemërin në rasën dhanore

I tha: *Më ngjan* që gënjuhesh,

pa mburresh kështu si gratë... / Naim Frashëri: HeS (114)

*Më ngjan* se erdhi / Sheperi: (159) /

*Më ngjan* që erdhi / Idem, Ibidem (159, 192) /

/ Drejtorin s'ma kishte zënë syri... Nga frika e përfytyronja si ciklop / ... Natën *më bëhej në ëndërr* sikur më rrokte për zverku e më përplaste nga një kontinent në tjetrin. / Sinaeri: Kokra aguridhe /





*Është turp të sillesh në këtë mënyrë ndaj pleqvet.*

*/... Qante Ndrekua, qante si kalaman /.*

b) — *Turp është të qash: të të rrojë Gjika, pa shtëpi më të mirë do të bësh!* — i jepnin zemër fshatarët... / Spasse: Ata... (254) /

— *Turp është t'u thom që s'mora vesh gjë nga ai muhabet.*

*/ Musaraj: Isha unë... (19) /*

Shpesh herë rendi «Emër + këpujë» është kushtëzuar nga fakti që fjalia sunduese e fjalisë kryefjalore përsërit strukturën e asaj fjalie pyetëse ose habitore që ka në përbërjen e saj fjalën pyetëse *sa*.

Por kur i thanë (fshatarit, S.F.) se çdo me thënë «Lëmi i parë shtetit», se ç'do me thënë të mejtosh më përpara për shtetin dhe se sa *turp është* të mbetesh prapa nga shokët, e di ç'bëri?

Kallëzuesi i fjalisë kryesore mund të përbëjë një thënie që vlerëson nga pikëpamja intelektualë ose morale-emocionale një fakt eventual të shprehur me fjalinë e varur kryefjalore. Ky kallëzues emëror është përbërë prej foljes këpujë «jam» por të shoqëruar prej emrave të tillë si *gabim, marrëzi, (budallallëk), mallkim* etj.

*Është gabim* të vihet kryefjala përpara lidhëzës së fjalisë së dytë, pa qenë edhe kryefjalë e fjalisë kryesore. / Sheperi: G. (199) /

*Ish marrëzi* të mendoje se Shqipëria e nesërme do të qe po ajo Shqipëri e mjerë që pat qenë, po ajo Shqipëri e një populli të shtypur e të prapambetur. / Shuteriqi, in M. Domi, Sintaksa<sup>3</sup> (158) /

— Dëgjo, Çobo vëllai, — vazhdon Xhezua. — ... *Është mallkim* nga Zoti të mos jemi të zot nashti për vehten tonë.

*/ Musaraj: Isha unë... (13) /*

Emri i kallzuesit emëror të fjalisë kryesore mund të prihet nga nyja joshquese *një* në disa raste. Shëmbull:

*/ Ahere, ishin kohë padrejtësirash. / Të transferoje një njeri nga vendlindja, tri ditë udhë larg, ta largoje nga shtëpija dhe katandija, mund të ishte një dënim i vërtetë. / Shuteriqi: Gurnecka (4) /*

I.1.2.3. *Brendia* e fjalisë së varur mund të vlerësohet si një fakt real, si diçka që ndjell habi, çudi etj. atëhere kallzuesi i fjalisë kryesore përbëhet prapë prej foljes-këpujë «jam» të shoqëruar prej emrave përkatës të vlerësimit; *fakt, çudi, sukses, fat*, etj.

*Është fakt* se populli shqiptar i kapërxeu të gjitha këto vështirësi dhe sot ai ka pozita ndërkombëtare të forta dhe të paprekëshme.

*/ E. Hoxha: 15-vjetori... (43) /*

Se *është* me të vërtetë *çudi* që trima kryelartë si ju, të rritur në liri, duruat kaq kohë robërinë e barbarëve, duke pritur që të më shikoni një ditë në kryen tuaj. / Noli: HeS<sup>2</sup> (29) /

*Është sukses* i madh për Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë që u krye një punë kaq e madhe brenda një kohe të shkurtër.

*Është një ditë e bardhë* për klasën punëtore... që fshatarësia jonë po del me guxim nga prapambetja. / E. Hoxha: Mbi fushatën (22) /

Kur vlerësimi i brendisë së fjalisë së varur bëhet nga pikëpamja intelektualë-morale dhe veç kësaj shprehet një emocion i fortë, gjithë kallzuesi i fjalisë kryesore dhe zaten gjithë fjalia mund të përbëhet vetëm prej një emri pa një në rasën emërore njejës pa parafjalë. *Brendia* e fjalisë kryefjalore përbën një fjali thirrrore-habitore. Një palë bashko-

hen me lidhëzën *që*, të tjera nëpërmjet të ndajfoljeve përkatëse *si*, *sa*; mund të ketë edhe tregues, gramatikorë-morfologjikë si mënyra habitore e foljes

*Gjynah që s'paske marrë vesh asgjë.* (!) / Shuteriqi: Çlir. (II)

Veziri (malësorëve të pabindur, S.F.)

Qafira, *turp që* nuk i shtroheni vullnetit të Sulltanit.

/ Luca: Shtatë shaljanët a.V. (65) /

I.1.2.4. Si kallëzuesor i kallëzuesit emëror shpesh herë përdoren emrat *punë*, *gjë*, të shoqëruar me një mbiemër cilësor. Ky mbiemër është elementi i pandashëm i kallëzuesorit, për arsye se emrat *punë* dhe *gjë* paraqiten me kuptimin e tyre shumë të përgjithshëm, ata kanë humbur shumë nga kuptimi leksikor dhe shërbejnë akoma vetëm si mbështetje morfologjike-sintaksore për mbiemrin, kurse ky mban gjithë peshën kuptimore të thënies, paraqit vlerësimin cilësor të faktit të shprehur në fjalinë e varur. Mbiemrat më të përdorëshëm janë: *e madhe*; *e vogël*; *e drejtë*, etj. Vetëm në raste të rralla, kur konteksti e tregon qartë ose kur nga konteksti mund të nënëkuptohet, mund të përdoret vetëm emri *punë*.

Vdekja është m'e mirë

nga turpi, nga robërija, (,)

sa është *pun' e pështirë*

të rrojmë si bagëtia. / Naim Frashëri: HeS (105) /

*S'është pun'e drejtë*

dhe për bakëtitë

të rrojnë pleqtë,

të vdesin të ritë.: Çajupi: Vepra, Kasapi /

— E di, shok, është *pun'e madhe* të jesh kryetar (këshilli, S.F.)

/ Gjata: Përmbysja, III, 3 /

E kishte provuar edhe ajo se sa *gjë e madhe ishte* të dashuronje.

/ Spasse: Ata... (149) /

— *S'është gjë e vogël* të jenë kaq shumë vetë që i thonë vehtes komunistë n'Elbasan, — vijoi Xhemali. / Shuteriqi: Çlir. (I) (166) /

Për Moskën është *gjë e rrallë* të bëjë në nëndor një ditë e bukur si kjo. / Musaraj: in M. Domi: Sintaksa<sup>3</sup> (157) /

Në një fjali thirrore retorike, kur mohohet brendia e fjalisë kryesore, folja-këpujë *jam* rëndom nuk përdoret.

— Budallaqe! U preke nga fjalët e nënës? Mos ia ver re asaj, i janë thartuar trutë!... *Pun'e madhe* se u thye një poç! / Gjata: Këneta (56) /

Në rast se nga konteksti nënëkuptohet qartë se cili mbiemër do të cilësonte faktin e përmbajtur në fjalinë kryesore, mbiemri mund të mos përdoret bashkë me emrin, dhe emri *punë* (në këtë rast vetëm ky emër dhe jo emri *gjë*, me qenë se vetë kuptimi leksikor i asaj fjale ka akoma mjaft nga kuptimi i *faktit*, *proçesit*) mund të përdoret vetëm. Në gjuhën e sotme (të folur dhe të shkruar) është normë përdorimi i emrit në emërore njëjës pa nyjë.

I.1.2.5 Gjuha shqipe ka fjali në të cilat shprehet identiteti midis kallëzuesorit dhe kryefjalës. Ky përbën një variant (nëndarje) të atyre fjalive që shprehin marrëdhënie midis së përgjithshmes dhe së veçantës.

Struktura e këtyre fjalive në shqipen dallohet për faktin se lidhja midis kallëzuesorit dhe kryefjalës, të shprehur që të dy me emëra, nuk

kryhet me anën e ndonjë foljeje këpujë si folja këpujë e mirëfillët *jam* ose ndonjë folje tjetër me funksionin e këpujës (*dukem, bëhem, etj.*), por me një ish periudhë «do të thotë» e cila duke u shndruar në një shprehje frazeologjike të ngurosur, kryen rëndom funksionin e këpujës *jam*. Marrim shëmbullin:

Në raste të tilla, ngurimi do të thotë vdekje, plogështija do të thotë disfatë, paaftësija drejtonjëse do të thotë katastrofë. / M. Shëhu: Lufta për çlirimin e Tiranës, Botim i dytë (56) /.

Në këtë shëmbull kemi tri fjali; për kryefjalën e secilës vihet shënja e barazisë me kallëzuesorin; sot shprehja «do të thotë» ka kuptimin «është baraz me...», ose thjesht «është»; krahaso: ... *ngurimi është vdekje, plogështija është disfatë*, etj. Në këto fjali kallëzuesori nuk ka për funksion të përcaktojë kryefjalën nga pikëpamja e llojit, por ve midis kryefjalës dhe vetë kallëzuesit shënjën e barazisë.

Në bazë të korelacionit kryefjalë-fjali e varur kryefjalore në periudhë midis fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur vendosen marrëdhënie kryefjalë-kallëzues.

**Të pushtosh një popull nuk do të thotë se e ke nënështruar.** / Abdihojha: Vjeshtë me stuhi (29) /.

Funksionin këpujor të shprehjes frazeologjike «do të thotë» e kryen më së miri edhe shprehja tjetër «domethënë», e cila sot përdoret në të dy kryedialektet, si dhe në gjuhën e shkruar. Fakti që toskërishtja, e cila nuk njihet paskajoren me pjesëzën *me*, e përdor këtë shprehje pa e ndjerë si element heterogjen në strukturën e vet, tregon se ajo perceptohet si një shprehje frazeologjike e pandashme me vlerën e një këpuje.

— Të duash komunizmin, domethënë të jesh ca komunist, — tha Hajdari / Shuteriqi: Çlirimtarët (I) (99) /.

Shprehja këpujë *domethënë* mund të sajojë me përemërin ç edhe një kallëzues emëror (këpujë + përemër) në periudha që kanë së paku tri fjali. P.sh.:

— Eh, more bir, — më thotë / baba, S.F. /, — s'e di ti se ç' domethënë të jesh në kurbet. të jesh larg atdheut, larg njerëzve të tu. Të digjet zëmra për këtë vënd. / M. Kallamata: Nete gjahtarësh (65) /. Në këtë shëmbull kemi një fjali kryesore (s'e di ti) një fjali të varur kundrinore (ç' domethënë) dhe dy fjali kryefjalore të bashkuara asindetisht.

Shprehjet frazeologjike këpujë janë barabar të përdorëshme, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar.

I.1.2.6. Në disa raste të rralla, kallëzuesori emër mund të vihet edhe në rasën kallëzore me parafjalën *me* (si p.sh. *me rëndësi te është me rëndësi*) etj.

Këta. shoku Col, lëvizjes komuniste i venë kazmën, dinamitin i venë, që të hedhin në erë... E kupton se sa *me rëndësi është* që t'i sjellim me vehte ata lloj studentësh e shokët e tyre? / Shter.: Çlir (I) (102)

I.1.2.6. Deri tani pamë në rolin e kallëzuesit emëror kallëzuesorë emra në trajtë të pashquar dhe me këpujën që i prin. Por kur kallëzuesi emëror i fjalisë që prin ka trajtën e modelit sintaksor «*E vërteta është + se (që) . . . . .*» p.sh. *E vërteta është që ftohtësia u bë armiqësi e rreptë, dhe mënt krisi lufta civile pak kohë më vonë* / Noli: HeS<sup>1</sup> (III) /, vlera e njërës fjali dhe e fjalisë tjetër krijon një problem mjaft të ndërlikuar. Tërë puna është të përcaktohet se cila fjalë bëhet objekt i predikacionit: emëri në trajtë të shquar (e vërteta) apo brendia e fjalisë «*me lidhëzën që*». Një palë linguistë, sidomos frëngj, duke u nisur nga veçoritë e gjuhës frënge lidhur me vendin e kryefjalës në fjali (rëndom vendi i

parë) janë shprehur në favor të mendimit se në tipe të tillë si fjali kryefjalore duhet marrë fjalia e kreit, kurse fjalia pasuese duhet marrë si fjali e varur kallëzuesore» (proposition attribut) (17). Në qoftë se nuk do të mirrnin për kriter të gjetjes së kryefjalës dhe kallëzuesit (dhe përkitazi të fjalisë kryefjalore dhe asaj kallëzuesore) një kriter më të shëndoshë se atë të rendit të gjymtyrëve kryesore të fjalisë (dhe atë të fjalive të varura), nuk do të bënin tjetër veç se do të merrnin në mënyrë mekanike skemën e sajuar (pavarësisht — me të drejtë a pa të drejtë) për një gjuhë të huaj, e cila, qoftë edhe nga pikëpamja e rendit të kryegjymtyrëve, ndryshon shumë prej shqipes.

Kemi thënë më lart se kallëzuesori emër klasifikon nocionin e shprehur nga kryefjala në një nocion më të përgjithshëm, pra emëri-kallëzuesor ka një vëllim më të gjërë se emëri-kryefjalë; kështu që shëmbulli, i mësipërmë nuk mund të transformohej në një fjali, sepse shkelet parimi i marrëdhënies midis së veçantës dhe së përgjithshmes për të cilin ka shkruar V.I. Lenini (shih § fq. . . .). E vërtetë është e kundërta e konstruktit, domethënë se ngjarja që shprehet me fjalinë e varur: «që ftohtësia u bë armiqësi e rreptë» vlerësohet si një fakt i vërtetë, klasifikohet nëpërmjet të nocionit më të përgjithshëm «e vërteta». Kështu pra kemi në fjali këso bashkëlidhesh kryefjalë-kallëzues me rend të anasjellë, për arsye thjesht stilistike:

*E keqja e të këqijave* që kish zënë tani Emira Velon *ish gjendja* në të cilën ajo *ish futur* pa kuptuar / Musaraj: Para agimit, «Nëndori» v. 1963,

Nr. 11 (17) /

Po *e keqja* më e madhe ishte *ajo e ftohtë* që ta mpinte tërë trupin, *ay tufan* që oshetinte si ndonjë xhind / A. Mara: Shtëpia e Xh. Milit (13) / Kështu pra, gjendja e Emira Velos, ose e ftohta dhe tufani vlerësohen nga kallëzuesori *e keqja* (e të këqijave, më e madhe), *e keqja*, si kategori nacionale më e gjërë klasifikon një send a fenomen të vetëm konkret, gjendjen e Emira Velos ose të ftohtit a tufanit.

Ne pra nuk mund të mjaftohemi duke lenë rrugë të lirë për të marrë njerën fjali daç si kryefjalore, daç si kallëzuesore, por do të pohojmë pa ngurimë se te periudhat e tipit «E vërteta është» + një fjali me lidhëzën *që* a *se* (dhe në raste të tjera si Emira është (që) + . edhe me *ish lidhëzën të*, sot pjesëzë trajtëformuese e trajtave kohore të mënyrës lidhore) fjalia e parë «e vërteta është», «e mira është. . . nuk mund të merret veçse si fjali kryesore, kurse fjalia tjetër si kryefjalore.

Si kallëzuesor të kallëzuesit emëror të fjalisë kryesore përdoren emëra me kuptim të caktuar leksikor, emëra relativisht të pakë në numur, që të gjithë emra abstraktë.

Si kallëzuesorë përdoret rëndom emri *puna*, dhe (rrallë) emëri *fakti*. Emëri *puna*, me një përdorim më së fortë popullor, ka një kuptim shumë të gjërë leksikor, po ashtu si dhe emëri *fakti*, i cili përdoret rrallë, sidomos në stile të gjuhës së shkruar (jo pa ndonjë ndikim nga gjuhë të huaja; cf. frëngjisht: *le fait est que*. . .). Trajta e shquar e emërit kallëzuesor *puna*,

17) W. Von Wartburg et Paul Zumthor «Précis de syntaxe du français contemporain», seconde édition, entièrement remaniée, Berne 1958, f. 77. Nuk e rimëkëmb situatën edhe vërejtja që bëjnë autorët, se «është e vërtetë që në këtë rast, fjalia e varur *complétive*, simbas mendimit të subjektit ligjëronjës, mund të jetë kryefjalë e fjalisë (sujet de phrase) (77).

*fakti* kushtëzohet nga fakti se nocioni i shprehur prej emërit mirret në tërë vëllimin e tij, si tërë *puna*, *puna kryesore*, *fakti kryesor*.

*Puna është* që Nasi u kthye në birucën e tij të parë, te sharrat / Gjata: Në pragun e jetës (130) Prova e parë /.

*Puna është* se Gungëllarët (...) e shpunë grindjen gjer në një vrasje të dytë / J. Xoxa: Novela (II) (29) /.

Qytetari II — *Fakti është* se ndërmarrja jonë është e prapambetur / I. Uruçi: Doktor Aleks, «Nëndori» Nr. 9, v. 1963 (34) /.

Atë ditë Mitron e nisën me letra, as unë s'e di për ç'vënd të largët. *Fakti është* se u vonua nja dhjetë dit për t'u kthyer / S. Xhai, Premtimi i heshtur (179) /.

Është e udhës të preferojmë konstruktin *puna është* e cila është shqipe dhe popullore.

1.1.2.7. Ndër kallëzuesorët ka edhe emra të dalë nga substantivimi i mbiemërave përkatës: e keqja, e mira, kryesorja, etj.) Ndër ta, më të përdorëshmit janë, pa dyshim, emërat *e mira* dhe *e keqja*, sepse tregojnë kategori shumë të gjëra, me të cilat operohet rëndom në jetën e përditëshme.

Kur fjalia kryesore ka si kallëzuesor emërin *e mira* (edhe me përsëritjen: *e mira e të miravet*) kallëzuesi i kryefjalores vihet në lidhore, kurse në rastin e kallëzuesorit e keqja, nuk përdoret lidhorja, por vetëm dëftorja, ose mënyrat që nga pikëpamja modale janë të baravlerëshme me të: kushtorja, habitorja, etj.

Këto pikëpamje mund të rrihen e biles jo vetëm një herë. Zaten *e mira është* që të rrihen më se një herë. / Shuteriqi: Çlirimtarët, (II) (V, 1.) /

Bëj përpjet e tatëpjetë,

Moj NS lule,

*E mira* (—) të vinje vetë,

Të mos mundosh ushtërinë. / KPLr, (166) Miçan /.

Kryetar i degës: Ç'kam bërë, shoku drejtor?

Drejtori : *E keqja është* se nuk ke bërë asgjë.

/ S. Çomora: Inzheksione... (56) /.

Kallëzuesori mund të përdoret nënë trajtën *më e mira*, *më e keqja* (të krahasores së mbiemërit cilësor të substantivuar).

Dhe *më e keqja ishte* se Gjika po e akuzonte / Aleksin / për marrëdhënie jo të drejta që kishte me të shoqen. / Gjata: Këneta (398) /

Nga mbiemëri kryesore edhe substantivuar emëri *kryesorja* dmth *puna kryesore*, çështja kryesore.

Ndjenja të çuditëshme po më lëvrinin përbrenda, por kryesorja që se ndjehesha mirë / S. Andoni: Portokallet, in «Dasmë e çuditëshme» (19).

Numuri i emërave që përdoren si kallëzuesorë sa vjen e bëhet më i madh, gjë që tregon prodhimtarinë e modelit.

1.1.3. Kallëzuesi emëror ka si kallëzuesor një mbiemër.

Fjalia kryesore, duke ngërthyer në kallëzuesin e saj një kallëzuesor mbiemër, i cili tregon në përgjithësi cilësi, vetijë a tipar, është e paracaktuar t'i apë brendisë së fjalisë së varur, e cila mban peshën kryesore të kumtimit në periudhë, një vlerësim nga pikëpamja e kuptimit leksikor të vetë mbiemërit. Ndër ta ka asish që përdoren më shpesh në situata të caktuara të jetës së përditëshme, si për vlerësime intelektuale të brendisë së varurës: *e vërtetë*, *e qartë*, si për vlerësime nga pikëpamja modale

e domosdoshmërisë etj. si *e mundur*, *e pamundur*, ose nga pikëpamja moralo-etike si *e drejtë*, *e padrejtë*, dhe nga ndonjë pikëpamje tjetër. Si këpujë përdoret më të shumtën e herës folja *jam*, por ndonjëherë mund të përdoren edhe folje të tjera si *duket*, *bëhem*, *dël*, etj.

Duke qënë se emri *punë* a *gjë* ka humbur shumë nga kuptimi i vet leksikor dhe është shndërruar pothuajse krejt në një fjalë që tregon fakt në përgjithësi, ai mund të lihet mënjandë dhe kuptimi i tij të ngërthehet tek mbiemri, i cili në këtë rast paraqitet si i substantivuar. Por në shqipet trajta gjinore e mbiemrit mbetet ajo e femërores, që kish pasur kur shoqëronte emrin *gjë* a *punë*. Ndër shkrimtarët tanë të Rilindjes, dhe sot në gojën e popullit mund të ndeshet akoma togfjalëshi emëror-mbiemëror, ndërsa për gjuhën e sotme është normë përdorimi i mbiemrit vetëm. Kjo del qartë edhe nga përçasja e dy shëmbujve të mëposhtme:

/Ata q'e njohinë Shqipëtarë (,) s'çuditenë me këto numëra, se kaq'ushtëri Shqipëria ka nxjer(rë) për herë/.

Dhe kjo është *pun'e diturë* që një ushtëri prej 200.000 Shqiptarësh është mbaras me një ushtëri 500.000 ushtarësh të huaj. /Sami Frashëri: Shqipëria. . . . . (27). /

Se është *e ditur* që çdo gjuhë e gjallë është folur dhe flitet me ndryshime, sipas vendeve, jo vetëm në shqipëtim, po dhe në trajta të fjalëve, dhe diku edhe në të lidhur të tyre për të shfaqur mendime; . . . /Sheperi : G. (IV) /

**I. 1.3.1. Kallëzuesori** fjalisë kryesore mund të jetë një mbiemër që tregon vlerësim të brendisë së fjalisë së varur kryefjalore nga pikëpamja e saktësisë, vërtetësisë, qartësisë së brendisë. Fjalja e varur bashkohet me kryesoren nëpërmjet të lidhëzave *se* dhe *që*.

Kallëzuesi mund të jetë pohor ose mohor.

Është fare e vërtetë se kurrë ndonjëherë nuk është parë një aktivitet i tillë krijonjës i masave. / E. Hoxha: 10-vjetori (30) /

Është kështu e afërmëndëshme që sot për sot kemi nevojë nga njëra anë të mbledhim me shpejti në një fjalor të tërë pasurin që ka gjuha, dhe nga ana tjetër t'a studiojmë këtë pasuri në gramatika. . .

/ Sheperi : (V) /

Është e qartë se me një trajtim më të mirë të bagëtisë para therrjes ne do të merrnim rreth 10%, ndoshta edhe më shumë mish dhe nga ana tjetër (,) nga ky trajtim, ( ) cilësia e mishit do të përmirësohej shumë. / E. Hoxha : Mbi masat. . . (29) /

Si folje këpujë e kallëzuesit të fjalisë kryesore mund të shërbejnë edhe foljet *bëhet*, *del*, *duket* etj.

*U bë e qartë* për çdo njeri se përgatitja e luftës së nxehtë, se lufta e ftohtë dhe politika nga pozitë e forcës ishte pjellja e qarqeve reaksionare monopoliste, të etur për fitime kolosale në kurriz të popujve. . . / Hoxha: Kong. III P (21-22) /

Këtej *del* akoma më e qartë se detyrat që do të dalin nga ky plenum i Komitetit Qëndror për shtimin e mishit dhe qumështit duhet të realizohen pa tjetër. . . / Hoxha: Mbi masat. . . (18) /

Është për të vënë në dukje se në ndonjë rast, si te shembulli i mëposhtëm i Naimit, mbiemri vihet pa nyjë, si një farë ndajfoljeje; këtu autori ka ndjekur mënyrën e përdorimit në të folmet popullore të disa krahinave të jugut (*është vërtet* = *është e vërtetë*).

. . . Po është vërtet që mua më desh shpirti më tepërë të shpëtonja

këtë, se ky më ka hipurë një herë në kafshët të ti më nj'udhë... / Naim Frashëri.

I.1.3.2. Kur brendia e fjalisë së varur vlerësohet nga pikëpamja modale e mundësisë, pamundësisë së ndodhjes së ngjarjes a veprimit së përfaqësuar nga fjalia e varur, e domosdoshmërisë, a nevojës së kryerjes së atyre që thuhet në fjalinë e varur, si kallzues emëror i fjalisë kryesore *kemi asht e mundur, është e pamundur, është e nevojshme, është e domosdoshme, është e kuptueshme, është e padurueshme*, etj.

«S'është e mundur, thoshnja, të ndrojtë nusja jonë tabijet. / Musaraj: Isha unë. . . . (21) /

— E shoh që u preke, — tha /kryetari/, — po nuk qe e mundur të prisnja akoma. / Musaraj : Isha unë. . . (28) /

Për shtimin e dërrit dhe të prodhueshmërisë së tij është e domosdoshme:

a) të bëhet shfrytëzimi i kujdesëshëm i dosave, të merren masa për ndërzimin e rregulltë të tyre, të sigurohet një pjellshmëri e lartë dhe të tregohet kujdes i veçantë për ushqimin dhe ruajtjen e shëndetit të gicave. / E. Hoxha: Mbi masat. . . (45) /

Veç foljes këpujë është në kallzuesin emëror mund të përdoren edhe foljet (më të, i etj.) *duket, shihet* (u pa, është parë) *u gjet*, etj.

Shtëpinë /Pali/ e kish në lagjen Shirkoll, pranë kazermave të Shkumbinit, në këndin tjetër të qytetit. I / *dukej e pamundur* të shkante me pushkë. / Shuteriqi: Çlir. (I) (66) /

Kjo dërgatë u kthyr prapë në Krujë pa mbaruar punë; dhe ahëre *u gjet e nevojshme* që të shkante në Napoli dhe në Romë për këtë mision vetë Skënderbeu, i shoqëruar prej provizorit Venecian të Lezhit Petro Marcello. / Noli: HeS<sup>2</sup> (72)

Mbiemrat e dala nga pjesoret e foljeve, me prapashtesën *-shme* tregojnë mundësinë e shtjellimit të veprimit a gjendjes së shprehur nga rrënjia a tema foljore, prandaj: është e kuptueshme = mund të kuptohet; është e padurueshme = nuk mund të durohet (këtu mbiemri është formuar njëkohësisht edhe me parashtesën mohore *pa*)

Është plotësisht e kuptueshme që populli shqiptar, i udhëhequr nga partia e tij heroike e punës, t'i kushtojë një vëmëndje të madhe dhe një kujdes të posaçëm forcimit të vazhdueshëm të pushtetit popullor. /

Agroni : Më fal, nanë, por *asht e padurueshme* . . .

(Melpomeni: Çfarë asht e padurueshme?).

Agroni: . . . Që të mos përfillen urdhnat e mija.

/ Xh. Broja : Majlinda, I (19)

Fjalia kryesore mund të përmbajë një fjali pyetëse retorike, zakonisht me fjalën pyetëse *si*. Në këto raste fjalia kryesore mohon mundësinë e ndodhjes së atyre që thuhet në fjalinë e varur.

/ Pyetjet që na vijnë në gojë menjëherë janë këto: E para: /. **Si** është e mundur që një çilimi prej nëntë vjetësh të rritet si Muhamedan gjersa u bë burrë i pjekur prej dyzet vjetësh, dhe pas të dyzetave të këthehet i Krishterë dhe të çfaqet përpara botës si një nga çampionët më të mëdhenj të Krishterimit? . . . / Noli HeS<sup>2</sup> (23) /

/ A thua se zanati i tij /Palit/ do të vinte dita e do të zhdukej, se nuk do të ish më i nevojshëm? . . . **Si** ish e mundur të mos përdornin më bota enët e bukura të bakrit, që vezullojnë me shkëlqimet e arit? / Shuteriqi : Çlir. (I) (54).

I.1.3.3. Kallzuesori e shkruar i kallzuesit emëror është shkruar i ep

këtij kuptimin *është e vendosur* nga fati, zoti etj., dmth. një kuptim modal të shprehjes së vullnetit okult.

/Skënderbeu — shqiptarëvet / —» / Shën Gjergji / Më tha që krahu i Perëndisë do të më mprojë mua dhe popullin ton... / *Se është shkruar në qjell të rronj edhe të vdes Kryezot i Arbërit...* / Noli: HeS<sup>2</sup>, 59 /

I.1.3.4. Kallzuesi i fjalisë kryesore mund të tregojë vlerësimin subjektiv të asaj që thuhet në fjalinë e varur. Si kallzuesorë përdoren atëhere mbiemra: a) të dalë prej emrash si e arësyeshme, e natyrëshme, e leverdisëshme, e zorshme; b) prej pjesorësh foljesh kalimtare veprorë: *e çuditëshme*; c) ndajfoljesh: *e tepër(t)*, si dhe ç) mbiemra të parme: e lehtë, e vështirë, etj.

Këta kallzuesia e vlerësojnë brendinë e fjalisë së varur nga pikëpamja e karakterit të natyrëshëm e logjik, a të leverdisë: *është e arësyeshme, e natyrëshme, e leverdishme*:

Që të mos e tepërojmë, pra, në toskërishten përdorimin e zërores ë: ... *është e arësyeshme* të mos shkruhet pa nevojë të dukurë...

/ Sheperi: G.: (11) /

*Është e natyrëshme* t'i mungojnë një gjuhe fjalët e sendeve që nuk i ka pasur kombi që e flet, dhe shfaqjet e mendimeve për të cilët ky nuk ka pasë nevojë. / Sheperi: V) /

Si rregull, *është më e leverdishme* që lindjet të bëhen në muajt kur ka shumë kullot, sepse sigurohet një rritje më e mirë e të vegjëlve. / Hoxha: Mbi masat... (45-46) /

I.1.3.5. Vlerësimi i brendisë së fjalisë së varur mund të bëhet nga pikëpamja e lehtësisë e vështirësisë së ndodhjes së ngjarjes që tregon ajo fjali; në këtë rast si kallzuesor në fjalinë kryesore përdoren mbiemrat *e lehtë, e rëndë, e vështirë, e zorshme*, /K. Jakova: Tj, II

-- Asht fare lehtë t'i jepet shkelmi një plaku në pleqni...

[Gjer tani Shqiptarët ishin mësuar me disfata dhe mjerime *Ishte e rëndë*, pra, të besonin që do t'u buzëqesh- Noli: HeS<sup>2</sup>, (35) / te fati...

Hapet zjarri nga të gjitha anët, porse *është jashtëzakonisht e zorshme* që të çahet bora përpjetë malit./

Në strukturën e fjalisë kryesore, përveç gjymtyrëve që përcaktojnë sasinë (si ndajfoljet *shumë, pak, fare, jashtëzakonisht* etj.) mund të ndodhet dhe një gjymtyrë që tregon personin a sendin për të cilët ajo që thuhet në fjalinë e varur është punë e lehtë, ose e vështirë. Një gjymtyrë shprehet me një emër me parafjalën për:

*Nuk është gjithnjë e lehtë për aparatin zëror* të shqiptojë dy zanore të njëjta a të shnjëjta në dy rrokje pran'e pranë, a dy bashkëtingëllore çfarëdo që vijnë njera pas tjetrës / Cipo: G. (12) /.

Siç janë fshatarët mjaft të drejtuar e që përpiqen më shumë të marrin se të japin, *qe mjaft e vështirë për Palin* të kuptojnë n'ato fshatra... se ç'mendonte shumica. / Shuteriqi: Çlir. (I) (72) /.

I.1.3.6. Me mbiemrat *e drejtë, e padrejtë* vlerësimi subjektiv i brendisë së fjalisë së varur bëhet nga pikëpamja e drejtësisë a padrejtësisë, pasaktësisë, kurse me mbiemrat *e paktë, e tepërtë, e mjaftueshme* vlerësimi bëhet nga pikëpamja sasiore.

— «Fjalët që i dëgjoj nga goja e të gjithëve janë: «Shqipëria u bë». Tani *do ish më e drejtë* të thuhej që nisi të bëhet ( ), dhe atëhere do t'ishim të gjithë në një mendje. / Noli: Ligjëron (48) /.

— *Është e tepër të vazhdoj*. / Cipo: S. (86) /.

— Pse e pakë është të kesh gjithë këto mjete? /

Në vënd të emrit *çudi*, si predikativ i kallzuesit emëror mund të përdoret edhe mbiemri i dalë prej tij: e çuditëshme. Edhe si në rastin e emrit, fjalia e varur bashkohet me ndajfoljen si:

[Myzaferi mendonte] *është e çuditëshme se si lidhet njeriu me njeriun kaq shpejt!* / Shuteriqi: Çlir. (II) (II,9...) /

I.1.4. Kallzuesi i fjalisë kryesore (i cili përbën zakonisht dhe tërë fjalinë kryesore) mund të jetë një shprehje foljore që përmban foljen këpujë *jam* dhe një emër foljor (me kuptimin e ligjërimit, të komunikuarit) në të pashquar me parafjalën *për*, pra: *është për të habitur, është për të përmëndur, është për të shënuar, është për të theksuar, është për të vënë re, është për të vënë në dukje*. Këto shprehje foljore tregojnë se brendia e fjalisë së varur kryefjalore është diçka reale që duhet të ngjallë habinë, duhet të bëhet objekt i një komunikimi me ndonjë nuancë të veçantë të mënyrës së komunikimit. Përdorimi i tyre kufizohet në vepra të stilit publicistik-shkencor.

Në gjuhën popullore duhet vënë re se pjesëza *u* e pësorës nuk përdoret, kurse në shkrimet e reja përdoret rëndom.

*Është për t'u përmëndur* se gjatë pesëvjeçarit të parë fshatarësia ka marrë nga shteti më tepër se një miliard lekë në formë krediti agrar. / Shehu, Kg. III P, A /

*Është për t'u shënuar* se në dy vjetët e parë të pesëvjeçarit të parë zhvillimi i bujqësisë dhe i blegtorisë ishte mjaft i ngadalshëm. / Idem, ibidem, A /

Këtu *është për të theksuar* se folja «bie» ka aspekt të një veprimi-pikë... / Cipo: S. (57) /

*Është për të vënë re* se proverbet bëjnë një përdorim të madh të vetes së dytë të çdo kohe e mënyre, po më fort të dëftores dhe urdherores. / Cipo: S. (44) /

*Është për t'u vënë në dukje* se për çështjet e blegtorisë, si nga ana e partisë (,) ashtu edhe nga ana e organeve shtetërore nuk tregohet po ai kujdes që tregohet për çështjet e bujqësisë. / Hoxha: Mbi masat (26) /

Duke përmbyllur pjesën e parë të punimit, mund të shtojmë se te periudhat me fjali të varur kryefjalore të tipit lidhëzor ffillëzonjës, kallzuesit e fjalisë kryesore kanë një larmi të madhe strukturore dhe semantike.

Ndonëse numuri i foljeve kallzues (tek kallzuesit foljorë) është relativisht i vogël, disa tipe foljesh kanë një përdorim mjaft të shpejtë, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Kallzuesit e shprehur me folje të ligjërimit, folje kalimtare pësore, përdoren rëndom sa herë që ligjëruesi ep brendinë e fjalisë së varur pa iu referuar ndonjë burimi konkret. Vetitë semantike të disa foljeve kallzues, të cilët në periudhë mbajnë një peshë kumtose anësore (sidomos me foljet *flitet, thuhet, dihet* etj.) apin mundësi për kthimin e periudhës në një fjali të pavarur dhe në një ndërmjetëse.

Gjuha e shkruar është pasuruar jo vetëm me elemente të gjuhës së folur popullore, por për nevojat e stileve të shkruar (sidomos të stilit publicistik-shkencor) përdor dhe formime paralele, të sajuara nënë mbiveprimin e gjuhëve të mëdha (sidomos frëngjishtes, rusishtes dhe italishtes). Brendia e ndërlikuar e veprave të stilit publicistik-shkencor ka dhënë shkas për një shtrirje të përdorimit të disa foljeve si kallzues foljor ose të disa kallzuesve emërorë me një kallzuesor emër, megjithëse semantika e foljeve dhe emërave e mbimërave gjithëmonë shtie kufizime në rrethin e fjalëve të përdorura.

LISTA E VEPRAVE NGA ËSHTË MARRË MATERIALI FAKTIK

(Shkurtimet)

- 1) Andoni, LP Sotir Andoni, «Lufta Partizane», T. 1959.
- 2) Andoni, Maleve Sotir Andoni, «Maleve në Shëndendre», T. 1958.
- 3) Andoni, Tnga M Sotir Andoni, «Tregime nga Morava», T. 1960.
- 4) Broja, M. Xh. Broja, «Majlinda», T. 1958.
- 5) Cipo, G. Kostaq Cipo, «Gramatika», T.
- 6) Cipo, S. Kostaq Cipo, «Sintaksa», T. 1952.
- 7) Çajupi, V. A.Z. Çajupi, «Vepra», T. 1957.
- 8) Çomora, Sl Spiro Çomora, «Syleshi», T. 1958.
- 9) Dine, VeD S. Dine, «Valët e Detit», Sofje, 1908.
- 10) Dozon, Mn A. Dozon, «Manuel de la langue chkiye ou albanaise», Paris, 1878
- 11) Dushi, UeV Kin Dushi, Udha e Velanit, T. 1955
- 12) Dushi, BeSh Kin Dushi, «Banorët e shkallës Nr. 6», T. 1958.
- 13) Fjalë të urta U.Sh. i Tiranës «Fjalë të Urta të popullit tonë», T. 1958.
- 14) Naim Fr. HeS Naim Frashëri, «Histori e Skënderbeut», T. 1953.
- 15) Naim Fr. IeP Naim Frashëri, «Istori e Përgjithshme për mësonjëtorë të para», Bukuresht 1886.
- 16) Sami Fr., Shqipërija Sami Frashëri, «Shqipërija ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të jetë» Botim i gjashtë T.? Fatmir Gjata, «Kënetë», T. 1959.
- 17) Gjata, K Fatmir Gjata, «Përmbysja», T. 1954.
- 18) Gjata, P Fatmir Gjata, «Tana» (botim i parë, T.1955)
- 19) Gjata, T<sup>1</sup> (T<sup>2</sup>) (Botim i dytë, T. 1959)
- 20) Gjeçov, KiLD A. Shtjefen K. Gjeçov, «Kanuni i Lekë Dukagjinit», Shkodër, 1933.
- 21) Hoxha, 10-vjetori Enver Hoxha, «Fjalim i mbajtur në mbledhjen solemne organizuar me rastin e Dhjetëvjetorit të çlirimit» T. 1954.
- 22) Hoxha: Kng III F. D. Enver Hoxha, «Raport mbi aktivitetin e Këshillit të Përgjithëshëm dhe detyrat e mëtejshme të Frontit Demokratik» (Mbajtur në Kongresin e III-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë) T. 1955.
- 23) Hoxha: Kong. III P. Enver Hoxha, «Raporti i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë në Kongresin e III të Partisë», T. 1956.
- 24) Hoxha, Mbi fushatën Enver Hoxha, «Mbi fushatën e zgjedhjeve të Këshillave Popullore të fshatrave dhe detyrat e Frontit Demokratik (Raport i mbajtur në mbledhjen e Këshillit të Përgjithëshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë më 26 shtator 1955. T. 1955.
- 25) Hoxha, Mbi masat Enver Hoxha, «Mbi masat që duhen marrë për shtimin me ritëm më të shpejtë të prodhimit të mishit dhe të qumështit», Raport

- mbajtur në plenumin e K.Q. të P.P.Sh. më 3.XI.1958, T. 1958.
- 26) Hoxha, 15-vjetori  
Enver Hoxha, «Fjala e mbajtur në mbrëmjen solemne kushtuar 15-vjetorit të themelimit të P.P.Sh. dhe 39-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit», T. 1956.
- 27) Kacori, PM (I)  
Thoma Kacori, «Për Mëmëdhenë», v. I. T. 1961.
- 28) Kacori: PM (II)  
Thoma Kacori: Për Mëmëdhenë, v. II. T. 1962.
- 29) Kallamata, GjeT  
Miço Kallamata. «Gjëmbat e Trëndafilin», T. 1955.
- 30) Kallamata, NGj  
Miço Kallamata, «Netë gjahtarësh», T.1959.
- 31) Kolea, Proverba  
S. Kolea «Një tufë proverbash»,
- 32) Kristoforidhi, GjiM  
K. Kristoforidhi, «Gjahu i Malësorëvet»,
- 33) Kokona, MeVeJ  
Vedad Kokona, «Me valët e Jetës», T.1961.
- 34) Kurti, PK<sup>2</sup> (I)  
Donat Kurti, «Përralla Kombëtare» Botim i II, Ble i I, Shkodër 1942.
- 35) Kurti, PK<sup>2</sup> (II)  
Ble i II, Shkodër 1943.
- 36) Kuteli, KASh  
Mitrush Kuteli, «Kapllan Aga i Shaban Shpatës» T. 1944
- 37) Kuteli, NSh  
Mitrush Kuteli, «Nete Shqiptare», T. 1944.
- 38) KPHs  
Instituti i Shkencave, «Këngë Popullore Historike» T. 1956.
- 39) KPLr  
Instituti i Shkencave, «Këngë Popullore Lirike», T. 1955.
- 40) KPLgj  
Instituti i Shkencave, «Këngë Popullore Legjendare» T. 1955.
- 41) Lambertz, AM  
Maximilian Lambertz, «Albanischen Märchen», Leipzig 1922
- 42) Levonja, Prf  
Besim Levonja, «Prefekti», T. 1961.
- 43) Luca, Shaljanët  
Ndrekë Luca, «Shtatë Shaljanët», T. 1958.
- 44) Nikaj, ShkeRr  
D.N. Nikaj, «Shkodra e Rrethime», Bukurusha», Botim i dytë. T. 1961
- 45) Nikaj, B.  
D.N. Nikaj, «Shkodra e Rrethime», Bukurusha», Botim i II T. 1961
- 46) Noli, DKiM, P.  
Fan Noli, «Don Kishoti i Mançës» Parathënie, T. 1956
- 47) Noli, I dhe F  
Fan Noli, «Izraelitë dhe Filistinë», Boston Mass 1907.
- 48) Noli, Hamleti<sup>2</sup>, P  
Noli, «Hamleti», Parathënie. Botim i II, T. 1960.
- 49) Noli, HeS<sup>1</sup>  
Fan Noli, «Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit) Mbretit të Shqipërisë. Botim i I, Boston, 1921.
- 50) Noli, HeS<sup>2</sup>  
Fan S. Noli, «Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë», Bot. i II i rip. dhe plotësuar. Boston Mass. 1950.
- Noli, HeS<sup>3</sup>,  
Idem, Botim i III, T. 1962
- 51) Noli, Makbethi<sup>2</sup>, I  
Fan Noli, «Makbethi», Introdiktë, Botim i II. T. 1957.

- 52) Noli, Othello 2, P. Fan Noli, «Tragjedi e Othellos» Parathënie, Bot. i II T. 1960.
- 53) Marko, Hasta Petro Marko, «Hasta la Vista», T. 1958.
- 54) Marko, Qyteti Petro Marko, «Qyteti i Fundit», T. 1960.
- 55) Migjeni, V Migjeni, «Vepra» Red. S. Luarasi; T. 1957.
- 56) Mitko, BlSh Thimi Mitko, Bleta Shqiptare.
- 57) Musaraj, ÇRr Shefqet Musaraj. «Isha unë Çobo Rrapushi», T. 1960
- 58) Musaraj, Njëzet ditë Shefqet Musaraj, «Njëzet ditë në Bashkimin Sovjetik, T. 1950.
- 59) Musaraj, Të shkuara Shefqet Musaraj, «Të shkuara — të paharruara» T. 1957.
- 60) Pedersen, AlTex Holger Pedersen, «Albanesische Texte mit Glossar», Leipzig 1895.
- 61) Postoli, LeK Foqion Postoli, «Lulja e Kujtimit», T.1957.
- 62) Postoli, PMeA Foqion Postoli, «Për mbrojtjen e atdheut»,
- 63) Sako, B Zihni Sako, «Bereqeti», T. 1951.
- 64) Sako, Ditë Zihni Sako, «Ditë të gëzuara», T. 1953.
- 65) Siliqi Ll, Mësuesi Llazar Siliqi, «Mësuesi», T. 1955.
- 66) Sinaeri, Kokrra Nella Sinaeri, «Kokrra aguridhe», T.1959.
- 67) Spasse, Afërdita... Sterjo Spasse, «Afërdita përsëri në fshat» T. 1955.
- 68) Spasse, Ata... Sterjo Spasse, «Ata nuk ishin vetëm», T. 1952.
- 69) Stermilli, RreVD Haki Stermilli, «Rreth Votrës Dibrane» Përralla të pabotuara. (Arkiv i Inst. të Folklorit)
- 70) Shehu, Kujtime<sup>1</sup> Mehmet Shehu, «Kujtime nga jeta e Brigadës së T S», Botim i I, T.
- Shehu, Kujtime<sup>2</sup> Idem, ibidem, Botimi i II T. 1959.
- 71) Shehu, Lufta<sup>1</sup> Mehmet Shehu, «Lufta për Çlirimin e Tiranës» Botim i I, T.
- Shehu, Lufta<sup>2</sup> Idem, Botim i II, T. 1959.
- 72) Shehu, Kong. III Mehmet Shehu, «Raport mbi rezultatet e realizimit të planit të parë pesëvjeçar dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik dhe kultural të R.P. të Shqipërisë në Kongresin e III të Partisë», T.1956.
- 73) Sheperi, Gramatika Ilia Dilo Sheperi, «Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqip sidomos e toskërishtes» Vlorë 1927.
- 74) Shuteriqi, G. Dh. S. Shuteriqi, «Gurnecka», T. 1957.
- 75) Shuteriqi, Çlir (I) Dh. S. Shuteriqi, «Çlirimtarët» Libër I, T. 1952.
- 76) Shuteriqi, Çlir (II) Dh. S. Shuteriqi, «Çlirimtarët» Libër II T. 1954/5.
- 77) Xoxa, Novela (II) Jakov Xoxa, Novela (II), T. 1958.

## R é s u m é

## LA PHRASE COMPLEXE A SUBORDONNÉE SUJET EN ALBANAIS CONTEMPORAIN

*Après un bref exposé des opinions émises par les auteurs albanais de textes scolaires sur les propositions sujet, l'auteur classe les propositions sujet en albanais moderne en trois groupes principaux, dont le premier comprend les types sémantico-structuraux explicatifs conjonctionnels énonciatifs et les types pronominaux-conjonctionnels interrogatifs-exclamatifs; le second — les types pronominaux corrélatifs et le troisième — les types pronominaux non-corrélatifs.*

*L'auteur expose en détail les traits sémantiques et structuraux des prédicats (verbaux et nominaux) de la proposition principale dans les phrases complexes à subordonnée sujet introduite par les conjonctions që, se (= que), sikur (= que, comme), kur (= quand) et si (= comment) et représentant dans la phrase une proposition énonciative indirecte.*

*Le prédicat verbal de la proposition principale peut être exprimé par des verbes transitifs passifs ou bien intransitifs (la plupart), dans la forme de la troisième personne du singulier. Le nombre de ces verbes est restreint au point de vue sémantique: verba dicendi, verba sentiendi, verba putandi et verba volendi. Le nombre des verbes intransitifs est encore plus restreint: les plus usuels sont les verbes qui expriment la manifestation (fortuite) de l'action (ndodh = il advient), ou bien (më) pëlqen (= il me plaît) etc.*

*Le prédicat attributif est aussi limité par des raisons d'ordre sémantique: certains substantifs exprimant des notions éthico-morales, des adjectifs de la même sémantique lexicale ou bien exprimant la facilité, la difficulté et des notions modales (nécessité, etc.). L'auteur exclut de la phrase complexe à subordonnée sujet les phrases dont la proposition principale contient un prédicat attributif composé du verbe copulatif et d'un adverbe de manière, étant donné qu'un tel prédicat attributif ne peut pas avoir un sujet grammatical, et par conséquent, par définition, ne peut pas prendre une subordonnée sujet.*

*L'auteur appuie ses conclusions sur un matériel abondant glané dans les textes écrits depuis la Renaissance albanaise jusqu'à nos jours, et les textes de folklore.*